Ndonjëherë duket më e lehtë të tregosh histori dhe përvoja personale, por kjo mund ta çojë diskutimin në grindje, sherr dhe akuzime. Përdorimi i skenarëve neutralë mundëson që të përqendrohemi mbi temën dhe të keni diskutim shumë më të lehtë dhe më të sigurt. Sidomos që në atë rast diskutimi mund të përqendrohet edhe mbi mënyrat dhe aksionet që duhet t'i ndërmarim që dhuna të mos përsëritet në të ardhmen. Nëse mësojmë të tregojmë histori pa identifikuar emra, situata dhe/ose persona të njohur, do të thotë se e respektojmë privatësinë e personit tjetër dhe ndihmojmë në të mësuarit e të gjitha anëve së bashku.

Aftësi për të dëgjuarit aktiv ose parafrazim

Një mënyrë për të shmangur keqkuptime në komunikimin është të dëgjoni bashkëbiseduesin me kujdes. Ai/ ajo pastaj mund të konfirmojë ose do të plotësojë dhe sqarojë përmbajtjen, dhe kështu ne do të jemi të sigurt në komunikimin. Një nga teknikat e dëgjimit aktiv është parafrazimi (refleksioni) i asaj që është treguar. Parafrazimi është ritregim i asaj që e kemi dëgjuar me fjalët tona, me që përmbajtja dhe kuptimi duhet mbetur të pandryshuar. Pra, kontrollojmë a e kemi kuptuar saktë. Qëllimi i kësaj teknike është të verifikohet dhe konfirmohet se çfarë kemi kuptuar dhe të tregojmë respekt për bashkëbiseduesin. Duke vepruar kështu, ai/ ajo inkurajohet të vazhdojë bisedën dhe të flasë më shumë.

Shembull i një përmbledhjeje të rastit të ritreguar: "A do të thotë që vajza nuk fliste fare atë natë sepse kishte frikë se të tjerët do të mendojnë se është budalla dhe do të tallen me të?"

Dëgjimi refleksiv stimulon diskutimin dhe është shumë më i mirë se një vlerësim dhe/ose miratimi i përgjithshëm, si "bravo", "një shembull i shkëlqyer" etj., sepse sqaron kuptimin, artikulon mendimin dhe inkurajon diskutim.

Promovimi i barazisë gjinore dhe pranimiti i dallimeve

Disa njerëz, të rinj dhe të rritur, nuk përputhen me nocionin tradicional të seksualitetit, apo me identitetet e vendosura gjinore dhe ky është "defekti" i tyre i vetëm. Ata përballen me diskriminim, përjashtim dhe persekutim, me

pasoja të rënda për mësimin e tyre, shëndetin dhe mirëqenien, kërcënimet për jetën.

Prandaj është me rëndësi që mësuesi të fillojë me tema për të drejtat e njeriut dhe pastaj t'i hapë temat për çështjet e gjinisë, në kuadër të cilës një vend të veçantë kanë çështjet mbi diskriminimin, stigmatizimin dhe dhunën ndaj të rinjve me orientim të ndryshëm seksual ose identitet gjinor. Është me rëndësi që mësuesi të jetë një model për sjelljen e respektuar ndaj diversitetit gjinor, që mund të arrihet në shumë mënyra dhe me shembuj të shumtë, duke e theksuar përfshirjen e "atyre më të ndryshmet", në vend të stigmatizimit të tyre, mohimi dhe përjashtimi / p.sh. histori të suksesshme të njerëzve transeksualë, ose për marrëdhëniet homoseksuale të personat e famshëm ose idolet pozitive të të rinjve etj./

Megjithatë, për këto tema duhet marrë parasysh konteksti/ kultura e arsimit. Ndërsa në disa vende këto tema prej kohësh janë pjesë e arsimit gjithëpërfshirës seksual dhe janë të njohura për nxënësit, dhe bashkësia ka programe efektive për përfshirjen dhe mbrojtjen e tyre, ka edhe mjedise të tjera, si mjedisi ynë, ku nxënësit, pjesërisht edhe mësuesit, nuk kanë njohuri të mjaftueshme, dhe shpesh paraqesin qëndrimet dhe besimet stereotipike, që e bën komunikimin mbi këto çështje të jetë jashtëzakonisht i vështirë dhe delikat. Në rrethana të tilla, më mirë është të ofrohen informacione të qarta dhe neutrale, pa dënim dhe tallje të diversitetit të seksualitetit dhe identiteteve gjinore. Duhet prezantuar një evidencë e detajuar se nënçmimi, stigmatizimi dhe përjashtimi i këtyre të rinjve nga bashkëmoshatarët dhe bashkësia më e gjerë, rezultojnë me pasoja serioze mbi zhvillimin dhe jetën e tyre.

Informimi rreth seksit, gjinisë, orientimit seksual dhe identiteteve gjinore

Kur i prezanton temat mbi çështjet gjinore, mësuesi duhet të shpjegojë dhe diskutojë me nxënësit dallimet ndërmjet termave dhe kuptimeve të tyre:

Tabela 8: Seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual – cilat janë dallimet

Karakteristikat e seksit	Karakteristikat e gjinisë	Karakteristikat e identitetit gjinor	Orientimi seksual
<p>Diferencat biologjike dhe fiziologjike të trupit mashkull dhe femër në lindje e përcaktojnë seksin mashkullor/femëror. Dallimet janë më të vogla, madje edhe të padukshme te personat interseksuale ose androgjenë. Dallimet seksuale janë për shkak të strukturës të kromozomeve dhe hormoneve të djemtë dhe vajzat.</p>	<p>Gjinia është një term që shpjegon dallimet në rolet gjinore, të krijuara nën ndikimin e normave dhe pritjeve shoqërore dhe kulturore dhe nëpërmjet identifikimit me modele. Ato transmetohen nga gjeneratë në gjeneratë.</p>	<p>Identiteti gjinor është termi që përshkruan ndjenjën e përkatësisë së një gjini të veçantë.</p>	<p>Orientimi seksual pasqyron tërheqjen seksuale që një person ndjen drejt një personi të seksit të njëjtë, të kundërt, ose të dy sekseve biologjike.</p>
<p>Me zhvillimin e veçorive seksuale dytësore në pubertet, tipike të seksit mashkull/femër, dallimet midis sekseve bëhen më të dukshme.</p>	<p>Ka dallime në rolet dhe normat gjinore në mjedise, kultura dhe kontekste të ndryshme.</p>	<p>Edhe pse në shumicën e rasteve ekziston një përputhje midis seksit biologjik dhe identitetit gjinor, ka situata në të cilat një person ndjehet sikur ai të ishte lindur/kapur në trupin e gabuar.</p>	<p>Orientimi seksual nuk ka pika prekëse me përkatësinë e një gjinie të caktuar, ose me seksin biologjik.</p>
<p>Karakteristikat e seksit nuk ndryshojnë deri në fund të jetës.</p>	<p>Dallimet mund të jenë të mëdha dhe të çojnë deri në eksploitim ose trajtim të pabarabartë, nëse rolet gjinore nuk vlerësohen njësoj. Ata mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.</p>	<p>Kur gjinia e fituar nga lindja nuk përputhet me ndjenjën e përkatësisë gjinore, bëhet fjalë për një person transgjinor. Mund të jetë një burrë transgjinor, ose një grua transgjinore, me që identiteti gjinor e përcakton drejtimin.</p>	<p>Orientimi seksual nuk është i mësuar, por ndodh me nevojat e para seksuale, që zakonisht lidhet me periudhën e pubertetit. Personat transgjinorë mund të kenë të gjitha llojet e orientimit seksual.</p>

* Terma të tjerë të rëndësishëm për të kuptuar dhe komunikuar në temën e DHBGJ –së janë shpjeguar në fjalorin në fund të këtij udhëzuesi

KUIZ I SHKURTËR PËR KONTROLLIM TË NJOHURIVE TUAJA

Përdorni pyetjet e mëposhtme për të kontrolluar njohuritë tuaja në lidhje me çështjet kyçe në kapitujt e mëparshëm. (Përgjigjet e sakta janë dhënë në fund.) Rrethoni pohimin që besoni se është e saktë.

1. Gjinia është ...

- a. Përcaktuar nga muaji në të cilin keni lindur
- b. Dallimet biologjike ose fizike midis meshkujve dhe femrave
- c. Qëndrimet në lidhje me atë që do të thotë të veprsh, flasësh, vishesh ose shprehesh si njeri apo si një grua.

2. Seksi është ...

- a. Përcaktuar nga muaji në të cilin keni lindur
- b. Dallimet biologjike ose fizike midis meshkujve dhe femrave
- c. Qëndrimet në lidhje me atë që do të thotë të veprsh, flasësh, vishesh ose shprehesh si njeri apo si një grua.

3. Cila nga këto nuk është një stereotip gjinor?

- a. Gratë janë të nënshtruara
- b. Burrat janë të fortë dhe dominues
- c. Gratë mund të lindin fëmijë
- ç. Burrat janë më mirë në matematikë dhe shkencë

4. Cila nga këta është një shembull i dhunës me bazë gjinore në shkollën?

- a. Një djalë tallet me një vajzë sepse ajo flet me zë të lartë
- b. Një vajzë refuzon të flasë me një vajzë tjetër, sepse ajo mendon se vajza tjetër mban rroba të shëmtuara
- c. Një djalë i madh shtyn një djalë tjetër në tokë, sepse shokët mendojnë se ai nuk është një burrë i vërtetë
- ç. Një grup nxënësish fërshëlajnë pas një vajze të re derisa hyn në shkollë

5. Cili nga këta shembujt e mëposhtëm është një shembull i dhunës verbale me bazë gjinore në shkollën?

- a. Një djalë i thotë një djali tjetër që është pederast.
- b. Dy vajza nuk i japin një vajze tjetër shans për të studiuar me ta.

- c. Një djalë përpiqet të prekë këmbën e vajzës pa lejen e saj duke punuar së bashku në një detyrë.
 - ç. Një grup djemsh përleshën pas një lojë futboll
- 6. Cili nga këta shembujt e mëposhtëm është një shembull i dhunës seksuale me bazë gjinore në shkollën?**
- a. Mësuesi i thotë një nxënëseje se ajo kurrë nuk do të regjistrohet në një universitet, sepse ai është vetëm për meshkujt
 - b. Një nxënës ndjek një nxënëse që shkon në tualetin dhe komenton se si trupi i saj ka ndryshuar dhe sa tërheqëse është.
 - c. Një vajzë vodhi gjerdanin e një vajze tjetër
 - ç. Një vajzë shtyn një djalë pasi ai i ka thënë se është e shëmtuar
- 7. Cili nga këta shembujt e mëposhtëm është një shembull i një dhune psikologjike me bazë gjinore?**
- a. Djemtë ngacmojnë dhe keqtrajtojnë një shok klase që iu duket si femër, e përjashtojnë nga lojërat e tyre dhe i thonë të shkojë të luajë me vajzat
 - b. Një shofer taksi përpiqet të ofrojë vozitje falas deri në shkollën në këmbim të shërbimeve seksuale
 - c. Një grup djemsh i thirrën një djali tjetër se ai është i ngathët dhe prandaj nuk mund të luajë futboll me ta
 - ç. Dy djem përleshën për një vajzë që i pëlqen të dyve
- 8. E saktë apo e gabuar? Ka më shumë mundësi që nxënësit që kanë një marrëdhënie pozitive me mësuesit të angazhohen më shumë në mësim, do të përpiqen sa më mirë që mundën dhe do ta konsiderojnë mësuesin për dikë të cilit mund t'i drejtohen për ndihmë.**
- 9. Cila nga pohimet e mëposhtme nuk është e vërtetë? Studimi tregon se nxënësit çmojnë kur mësuesit e tyre:**
- a. Buzëqeshin dhe i përshëndesin nxënësit
 - b. Janë të interesuar për atë që bëjnë nxënësit
 - c. Mbajnë disiplinë të rreptë
 - ç. Tregojnë se janë krenarë me nxënësit e tyre
- 10. Cila pohimet nga të mëposhtmet nuk është e mirë që arsimtari t'i tregojë një nxënësi i cili raporton dhunë?**
- a. Unë dua të ndihmoj
 - b. Mund të më tregosh më shumë për atë që po ndodh?
 - c. Nuk dua më të dëgjoj për këtë
 - ç. Kjo shkollë dëshiron t'i japë fund kësaj sjelljeje

Përgjigjet: 1:c, 2:b, 3:c, 4:c, 5:a, 6:b, 7:a, 8:saktë, 9:c, 10:c

PJESA:

2.

**Biseda dhe aktivitete me
nxënësit në klasë**

2.1

Kuptimi i gjinisë dhe i barazisë gjinore

Në pjesën e parë të këtij kapitulli do të hapen, hulumtohen, diskutohen, luhen tema të ndryshme të lidhura me gjininë, normat dhe mitet gjinore, si dhe rolin e modeleve në ndërtimin dhe ndryshimin e situatës. Nxënësit janë pjesëmarrës aktivë në procesin e të mësuarit.

TEMA 1:

**Konceptet e gjinisë dhe barazisë
gjinore nëpërmjet prizmës së
kulturës normative të gjinisë**

PUNËTORIA 1:

Biseda e hapur për seksin biologjik, gjininë dhe identitetet gjinore, seksualitetin dhe normat gjinore

Tema e dhunës me bazë gjinore lidhet në mënyrë të pashmangshme me dallimet biologjike midis sekseve, por edhe me dallimet në normat shoqërore dhe kulturore dhe pritjet që lidhen me rolin gjinor të "burrit" ose "gruas".

Mësimdhënësi shpjegon për shtigjet dhe rolet e ndryshme që një burrë dhe një grua në jetë kanë në lidhje me përkatësinë e tyre në seksin/ gjininë e dhënë. Në bisedë me nxënësit, mësuesi përpiqet të gjithë së bashku të përcaktojnë se cilat prej këtyre dallimeve janë përcaktuar biologjikisht, kurse të cilat mësohen nën ndikimin e mjedisit dhe kulturës.

Ushtrimi 1: Stuhi idesh për karakteristikat tipike të një burri dhe një gruaje

Nxënësit njihen me temën duke renditur karakteristikat, atributet dhe rolet tipike në përshkrimin e një burri dhe një gruaje. Propozimet janë shkruar në një fletë të madhe letre.

Mësuesi sqaron se përveç se të gjitha karakteristikat e përmendura tipike të meshkujve dhe femrave, ka edhe forma të tjera të identifikimit seksual dhe gjinor, të tilla si interseks, te personat me shenja atipike seksuale, fizike ose kromozomale të seksit, të cilët e kanë të vështirë të identifikohen si një burrë ose grua. Ashtu siç ekziston edhe gjini i tretë te personat që nuk duan të identifikohen si mashkull apo femër.

Personat transgjinorë për të cilët ende pak flasim te ne edhe pse gjithnjë e më shumë njihemi me djem dhe vajza transgjinore në mjedisin dhe në shkollat tona, kanë identitet gjinor që është i kundërt prej seksit të tyre biologjik dhe ata shpesh thonë se ata ndihen sikur janë lindur në trupin e gabuar.

Orientimi seksual është një reflektim i dëshirave dhe lidhjeve seksuale me përfaqësues të së njëjtës, të kundërtën ose të dy sekseve biologjike dhe lidhet me ndjenjat e thella intime që janë krejtësisht legjitime dhe nuk

lidhen me identitetin gjinor dhe përkatësinë gjinore. Shprehja gjinore është vetëm një manifestim i jashtëm i identitetit gjinor, nëpërmjet sjelljes, gjestit, veshjes, stilit, stilit të flokëve, ngjyrës së zërit etj. dhe nuk duhet të ndjekë karakteristikat tipike femërore apo mashkullore. (Grafiku 2)

Pasi do t'i shpjegojë dallimet mes seksit, gjinisë, identitetit gjinor, shprehjes gjinore dhe orientimit seksual (Grafiku 2, Tabela 8), mësuesi thekson dallimin mes karakteristikave të lindur biologjike/ fiziologjike të trupit të meshkujve/ femrave dhe rolet e mësuar gjinore.

Karakteristikat biologjike dhe fizike të trupit të mashkullit dhe femrës janë dhënë nga lindja, me strukturën kromozomale dhe funksionin e hormoneve, dhe kjo përcakton seksin mashkullor/ femëror. Në disa raste, seksi nuk është qartësisht mashkullor ose femër, por është përzjerje e të dy seksëve për shkak të zhvillim atipik të karakteristikave fizike seksuale, strukturës kromozome dhe aktivitetit të hormoneve.

Rolet gjinore i pasqyrojnë pritjet e standardizuara që bashkësisë (kultura) i vendos para një burri ose një gruaje. Më e rëndësishmja, këto norma gjinore bazohen vetëm mbi dikotominë meshkuj-femra, i formojnë qëndrimet dhe gjykimet tona për atë që është e drejtë apo e gabuar, normal ose e sëmurë, në mënyrën se si dukemi, si sillemi, si flasim dhe si shprehemi. Më shumë kjo ndikon edhe mbi të drejtat themelore të njeriut në zhvillim, liri dhe jetë.

Fëmijët, që nga mosha më e re, mësojnë të ndjekin pritjet e roleve gjinore, shpesh herë ndryshe nga mënyra se si ndihen për përkatësinë e tyre gjinore. Gjatë zhvillimit të tyre ata janë nën ndërhyrjen e vazhdueshme korrektuese nga ana e familjes, bashkëmoshatarëve, shkollës dhe mediave. I gjithë socializimi në fakt e kalojnë në miratim dhe zhvillim të identifikimit të tyre gjinor.

Në diskutim, mësuesi mund të nxjerrë më shumë konkluzione, për shembull: se çdo kulturë ka "rregullat" e vet ose pritjet që përcakton përpara djalit ose vajzës në lidhje me mënyrën e sjelljes në përgjithësi, ose në raste të caktuara, siç janë rrobat, stili i flokëve, komunikimi tipit etj.

Kështu, në shumë kultura prej djemve pritjet që të tregojnë se janë të fortë, trima dhe t'i mbajnë emocionet nën kontroll, një ditë të bëhen njerëz të fuqishëm dhe të suksesshëm, ndërsa prej vajzave pritjet të tregojnë përrulësi, bindje dhe të jenë "të dëgjueshme", dhe ashtu, një ditë, të kërkojnë mbrojtje nga gjinia e kundërt, në figurën e burrit, të bashkëshortit, të partnerit, të shefit.

Ushtrimi 2: Stuhi idesh për karakteristikat tipike të një burri dhe një gruaje

Mësimdhënësi bisedon me nxënësit për kohën kur ata u bënë të vetëdijshëm për rolet e tyre gjinore – sipas mënyrës se si prindërit i veshën, këshilluan dhe i lejuan që të silleshin dhe argëtoheshin në një mënyrë të caktuar, ose se si ishin të përfshirë në punët në shtëpi dhe në aktivitete të tjera. Diskutimi mund të vazhdojë edhe për kohën siç ishte dikur, me prindërit e tyre, ose për krahasime me kulturat e tjera, për të cilat nxënësit kanë njohuri.


Por, disa njerëz nuk janë të kënaqur nga këto pritje, sepse mendojnë se ata mund të shprehen më shumë ose më ndryshe, ose për shkak se dallohen shumë nga imazhi "tipik", ndërsa ka edhe njerëz që nuk ndihen rehat në trupin e vet.

Mund t'i nxisni nxënësit që të mendojnë për situatën komplekse dhe të vështirë të fëmijëve dhe të rinjve interseksualë ose djemve dhe vajzave transgjinerë dhe të identifikohen me pozicionin e tyre në mënyrë që të bëhen më të vetëdijshëm për vështirësitë e jetës së tyre me të cilat ballafaqohen çdo ditë¹⁵. Mësuesi mund të japë shembuj nga jeta e këtyre fëmijëve.

(Temën për të rinjtë transgjinerë, arsimtari mund ta hapë këtu ose brenda temës së dytë të këtij kapitulli, mbi barazinë dhe të drejtat e fëmijëve për mosdiskriminim).

15 Greytak, E., Harsh realities: The experiences of transgender youth in our nations schools, in The School Report. 2007, GLSEN; Stonewall New York.

Karakteristikat e seksit, gjinisë dhe orientimit seksual



Grafiku 2

Aspektet gjinore dhe orientimi seksual



Grua

IDENTITETI GJINOR



Queer



Burrë



Orientim heteroseksual

ORIENTIMI SEKSUAL



Orientimi biseksual



Orientimi homoseksual



Seksi femëror

SEKSI BIOLOGJIK



Ndërseksi



Seksi mashkullor



Të shprehurit femëror

TË SHPREHURIT GJINOR



të shprehurit androgjen



të shprehurit mashkullor

Ushtrimi 3: Shembuj të nxënësve rreth mundësive të pabarabarta

Nxënësit në grupe japin shembuj të qasjes së pabarabartë në arsim ose përfitime dhe mundësi të tjera që nuk janë të barabarta për djemtë dhe vajzat. Pastaj ata diskutojnë se ku na çon kjo dhe se si zakonisht përfundon.

Për shembull, në disa mjedise, vajzat, ndryshe nga djemtë, edhe pse ndjekin mësimdhënien, nuk janë çliruar nga detyrat shtëpiake dhe kujdesen për vëllezërit e motrat e tyre më të vegjël. Trajtimi i tillë i pabarabartë ndaj edukimit të vajzës, mund të rezultojë në vetëbesim të ulët, ulje të ambicieve, ndërprerjen e hershme të arsimit dhe martesën e hershme, e cila e ndryshon tërësisht jetën e vajzave. Nga ana tjetër, edhe djemtë, prej të cilëve pritet të kenë sukses dhe të kujdesen për mirëqenien e të gjithë familjes, e kanë të vështirë të kryejnë detyrën dhe, nëse dështojnë, ndihen si humbës.

Pabarazia në qasjen në arsim dhe burimet e tjera për jetë, si dhe pritjet prej të rinjve që të jenë të suksesshëm në aktivitetet, disiplina dhe profesionet e ndara sipas gjinisë, mund të ketë pasoja afatgjata për jetën e tyre, pavarësisht nga cilës gjinie i përkasin. Përsëri, më të prekurit janë të rinjtë transgjinorë, të cilët rrallë mbijetojnë në mjediset e shkollave tradicionale, për shkak e braktisin shkollën para kohe.

Shkalla e arsimit, si dhe liria e zgjedhjes, ndikojnë drejtpërsëdrejti mbimundësitë dhe perspektivat e jetës së të rinjve dhe në mënyrë indirekte edhe mbi shanset e gjeneratave të ardhshme. Prindërit (e ardhshëm) të arsimuar dhe të kënaqur nga zgjedhjet e tyre, kanë fëmijë më të shëndetshëm, marrëdhënie më të qëndrueshme, mundësi dhe vende pune më të mira, dhe pjesëmarrje më të madhe në jetën e tyre dhe në komunitetin.

Rezime mbi gjininë, normat dhe mundësitë gjinore

Ka dallime të mëdha midis termave dhe nocioneve: seksi, gjinia, normat gjinore, identiteti gjinor, orientimi seksual dhe karakteristikat e tyre shprehëse.

Rolet dhe pritjet gjinore mund të ndryshojnë.

Disa norma gjinore janë të dëmshme dhe mund të ndikojnë që njerëzit të heqin dorë nga gjërat për të cilat ata janë të interesuar dhe për të cilat besojnë se janë zgjidhja e duhur për ta.

Është në rregull që njerëzit të mos pajtohen dhe të mos jenë në përputhje me normat dhe stereotipat gjinore.

Bashkësia /kultura e cila nuk ka mjaft njohuri dhe tolerancë për diversitet, shpesh "zgjedh" të mos i shohë, ose t'i shpallë "të sëmurë", në vend që të informohet dhe t'i përfshijë në radhët e saj (personat transgjinorë, interseksualë, homoseksualë).

PUNËTORI 2.

Efektet e gjinive negative mbi shëndetin dhe sigurinë e të rinjve

Ndryshe nga vajzat, të cilët shpesh ankohen për simptoma psikosomatike, të tilla si dhimbje koke, dhimbje barku, pagjumësi, që përdorin edhe medikamente, djemtë janë më të ekspozuar ndaj sjelljeve të rrezikshme të tilla si pirja e alkoolit, pirja e duhanit, seksit të pambrojtur, sjellje agresive dhe lëndimet. Rezultatet e studimit ndërkombëtar të kryer edhe në Maqedoni, tregojnë prevalencë më të lartë të neurozave (52%) tek vajza në Maqedoni, në Evropë, që është dy herë më e lartë se ajo e djemve (27%). Këto gjendjet kanë pasoja të thella për shëndetin mendor të të rinjve, por edhe pas zgjedhjeve të tyre të tanishme dhe perspektivave afatgjata në jetë.

Ushtrimi 1: Rinia dhe ndikimi i edukimit korrigjuese të gjinisë

Nxënësit (në grupe) kujtohen dhe diskutojnë pritjet, këshillat, mesazhet, lejet/ ndalimet nga prindërit ose të tjerët në mjedisin e tyre, që lidhen me sjelljen, shprehjen, veshjen, fjalën, të lidhur me rolet gjinore, për të cilat vazhdimisht ndihen se i kanë të imponuar.

Nxënësit flasin për mënyrën se si ndihen dhe si përballen? Çfarë pranojnë, dhe çfarë jo dhe si luftojnë për veten në këto rrethana?

Si do të ndiheshin të gjithë të rinjtë të tjerë me përkatësi atipike gjinore, në të njëjtat rrethana? Çfarë porosie do t'ua dërgonin për kërkesat dhe pritjet e tilla?

Për shembull, djemtë prej të cilëve pritet që të jenë të fortë dhe trima, ndaj vështirësive shpesh reagojnë me sjellje të rrezikshme, të tilla si alkooli, droga, dhe dhuna, në vend që hapur të bisedojnë për këto vështirësi. Ata nuk guxojnë të tregojnë dobësi dhe t'i raportojnë problemet e tyre emocionale, sepse "burri nuk bën ashtu" "nuk i përshtatet" dhe dëmton shumë imazhin e idealizuar për forcën dhe fuqinë e figurës mashkullore. Dhe janë plotësisht të pavëmendshëm se kjo i largon nga marrëdhëniet e afërta dhe cilësore me të tjerët. Sidomos në kulturat ku ka mungesë respekti për tjetrin dhe për diversitetin, pritjet e tilla shkaktojnë që djemtë ta kalojnë pakënaqësinë dhe frustrimin mbi personat më të dobët. Ata persona më shpesh janë, vëllai/ motra më i/e vogël, shoku/shoqja, ose partneri/partnerja, ose dikush tjetër ndoshta edhe i panjohur, por i ndryshëm prej tyre.

Nga ana tjetër, vajzat, të trajnuara për të qenë të dobëta dhe të pafuqishme, tregojnë tendencë më të shpeshtë për problemet e shëndetit mendor, siç janë depresioni dhe nervozizmi. Thellësisht të pakënaqura me veten dhe se "askush nuk i kupton", ato shpesh kërkojnë strehim në lidhjet e hershme intime dhe/apo martesë, me shpresë se ndoshta aty do t'i plotësojnë rolet e porealizuara (gjinore). Këto gra të nënshtruara dhe të lodhura, me vetëbesim të ulët, mbeten një pre e lehtë e kontrollit dhe "mbrojtjes" nga të tjerët, me të cilët kurrë nuk do të mësojnë se si duhet përballuar, njësoj si me zgjedhjet e këqija jetësore për shëndetin e tyre dhe shëndetin e fëmijëve të tyre.

Rezultati i tillë i gjërave, kryesisht ndodh për shkak të mosinformimit, mungesës së të menduarit kritik dhe mungesës së shkathhtësisë së të rinjve të përballojnë presionet e normave të rrepta gjinore, të cilat, shumë rrallë ndodhet që dikush të përpiqet t'i sfidojë ose t'i ndryshojë nëpërmjet marrëdhënieve pozitive dhe të respektueshme me fëmijën, në krahasim me skenarët katastrofikë që u ofrohen. Dhe, nëse kjo ndodh, përjashtime të tilla pothuajse nuk përkrahen as inkurajohen nga shumica.

Në të njëjtin kontekst të normave të rrepta gjinore, të rinjtë transgjinorë janë në një pozitë edhe më të vështirë. Ata jetojnë në kaosin e trishtimit, pafuqisë dhe dëshpërimit, mjaft i vetmuar para presioneve sociale të jenë atë që ata nuk janë, ndërsa pa sukses tentuar të provojnë se kush janë, shpesh pa mbështetjen e të afërmeve. Më guximtarët prej tyre informohen dhe lidhen me njëri-tjetrin ose me grupe të mbështetjes, komunikojnë në përmes rrjeteve virtuale dhe shoqërohen, duke pasur ndërmend se nuk janë vetë. Disa prej vendosin të fillojnë me terapi të hormoneve pas ose para pubertetit (me bllokatorë të hormoneve) që ta korrigjojnë/vonojnë ndryshimin natyror të trupit dhe t'ia afrohen identitetit të tyre gjinor. Stigma dhe diskriminimi që i ndjekin, përgjithmonë shënojnë jetën e tyre me një prevalencë të lartë të kushteve depressive, izolimi social dhe tentime për vetëvrasje, për të cilat vendosen në momente krize, si e vetmja mënyrë për të dalë nga vuajtjet e tyre.

Ushtrimi 2: Ndryshimi i pritshmërive gjinore nëpërmjet karaktereve të tregimeve për fëmijë:

Nxënësit kanë për detyrë të zgjedhin nga një tregim për fëmijë ose tregim popullor që përforcon normat stereotipe gjinore, dhe ta ritregojnë, por personazhet kryesore do të shfaqen me karakteristika të kundërta prej stereotipeve gjinore. Mësuesi i inkurajon nxënësit që të përgatisin tregimet dhe pastaj t'i lexojnë me grupe të fëmijëve më të vegjël dhe të raportojnë për reagimet e fëmijëve.

Ritregimi mund të ndihmojë t'i mësojnë më të rinjtë si të dalin nga normat e ngushta gjinore dhe se ata mund të jenë të pranuar dhe respektuar edhe nëse janë të ndryshëm nga ajo që pritet prej tyre.

Rezyme për efektet e normave gjinore mbi shëndetin dhe jetën e njeriut

Pritjet dhe normat gjinore ndikojnë në mënyrën se si një person jeton jetën e tij dhe çfarë janë perspektivat e jetës së tij.

Disa norma janë imponuar dhe të dëmshme dhe çojnë në pabarazi të mëdha. Prandaj është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi për rolin dhe ndikimin e tyre në shëndetin dhe mundësitë e njeriut dhe të tentojmë t'i ndryshojmë normat e kufizueshme.

Çdo person duhet të ketë qasje të barabartë në burime për zhvillim dhe pjesëmarrje në komunitet, pavarësisht nga vetëpërcaktimi i tij të seksit, gjinor dhe/ose orientimi seksual

PUNËTORI 3.

Ku dhe si mësohen rolet dhe normat gjinore – porositë e mediave?

Rolet gjinore mësohen në familje, nga modelet e sjelljes, ndër të cilat më shumë ndikim kanë prindërit. Por, shumë ndikim ka edhe mjedisi, me kulturën e vlerave të transmetuara përmes edukimit, mediave (pop kultura) dhe artit (filmit, letërsisë).

Fëmijët kanë idhuj që duan t'i ndjekin dhe imitojnë. Ata lexojnë revista, libra, komunikojnë në mënyrë aktive përmes mediave elektronike, shikojnë seri televizive, dëgjojnë muzikë. Ata krahasohen, diskutojnë, identifikohen ose tallen dhe refuzojnë shumë persona publike që janë profiluar nga pikëpamja gjinore.

Ushtrimi 1: Roli i mediave në afirmimin e roleve dhe rritjet gjinore

Nxënësve u jepet mundësia të shqyrtojnë disa revista ose gazeta dhe të analizojnë se si janë përfaqësuar burrat/ gratë në to. A ndjekin ato normat kulturore dhe pritjet e roleve tipike gjinore në komunitet? Për shembull: Burrat janë prezantuar si udhëheqës, trajnerë, politikanë, kriminelë, etj. me fuqi dhe aftësi udhëheqëse. Në anën tjetër, gratë paraqiten më shpesh si bukuroshe, nëna, të butë, të pambrojtur dhe si kujdesen për të tjerët...

Grupi i bashkëmoshatarëve është jashtëzakonisht i fuqishëm në zgjedhjen dhe vendimet për të tërhequr ose përjashtuar të rinjtë nga radhët e veta. Ky grup mund të jetë madje më kufizues në kërkesat e anëtarëve të tij, nëse mbështetet në imazhet/ idhujt e idealizuar dhe joreal gjinor. Normat që grupi i imponojnë janë kritike për të gjithë ata që përpiqen të marrin mbështetjen e grupit, që praktikisht e bën grupin të pakrahasueshëm me ndonjë gjë tjetër.

Ushtrimi 2: Rolet e dëshiruara/ e idealizuara gjinore

Nxënësit, në grupe të vogla, diskutojnë për idealet e roleve gjinore që i çmojnë shumë dhe kanë aspirime t'i arrijnë. Ata flasin për tema siç janë për shembull se si, sipas tyre, duhet të duket një vajzë ideale apo një djalë ideal? Cilat karakteristika, tipare, dhe sjelljet, sipas tyre, do të ishin të dëshirueshme dhe të cilat nuk do të ishin? Dhe çfarë është ajo që e bën një djalë apo vajzë të jetë i/e dëshiruar/ refuzuar midis shokëve/ moshatarëve? Si kjo mund të ndikojë mbi imazhin për vetveten, mbi miqësinë, përfshirjen dhe vetëbesimin? Si reagojnë djemtë dhe si vajzat? A ka mundësi që të shmanget përkushtimi i këtyllë për hyrje dhe pjesëmarrje në grupin e bashkëmoshatarëve?

Mësuesit, si dhe prindërit, kanë përgjegjësi të madhe për t'u ndihmuar fëmijëve të fitojnë aftësi për identifikim të hershëm dhe ballafaqim në mënyrë efektive me të gjitha format e diskriminimit gjinor dhe dhunës.

Rezyme mbi efektet e normave gjinore mbi shëndetin dhe jetën e njeriut

Normat dhe pritjet gjinore mësohen dhe zbatohen në familje, shkollë, bashkësi. Disa prej tyre janë të dëmshme dhe diskriminuese dhe krijojnë pabarazi të mëdha gjinore.

Njohja e origjinës dhe ndikimi i normave gjinore ndihmon në përgjigjen ndaj (pa)drejtësisë dhe dëmtimit të roleve dhe pritjeve gjinore.

Është mirë që të rinjtë t'u thonë JO roleve dhe pritjeve gjinore të padrejta.

PUNËTORI 4.

Kundërshtim i normave dhe stereotipave negative gjinore

Normat negative kanë një ndikim të fortë negativ (shkelje dhe kufizime) mbi liritë dhe të drejtat e të rinjve. Prandaj, nxënësit duhet të inkurajohen të njohin, të përballojnë dhe pa u ndjerë fajtorë, t'i problematizojnë dhe t'i ndryshojnë ato. Prindërit duhet të jenë të ndjeshëm ndaj vërejtjeve të fëmijëve të tyre dhe t'i respektojnë, sepse ata tregojnë shumë për mënyrën se si ndihen fëmijët në rolet e tyre gjinore.

Shembuj të pyetjeve të shpeshta që vajzat i referohen prindërve për marrëdhëniet e tyre, të cilat ata mendojnë se janë të padrejtë.

- *Pse unë duhet të vij në shtëpi më herët apo duhet t'ju them se ku po shkoj dhe kur duhet të kthehem, kurse vëllai im nuk është i detyruar?*
- *Pse unë duhet të ndihmoj në pastrimin dhe larjen e enëve, dhe ai nuk duhet të ndihmojë? ose*
- *Pse unë, kur studioj, është diçka normale kurse ai nuk mëson dhe ka gjithçka që dëshiron?*

Ose

Shembuj kur një prind ankohet se djali i tyre:

- *nuk ka interes për ndonjë sport, por preferon të kërcëjë, ose të vizatojë*
- *ai dëshiron vetëm të luajë me kukulla, ose është në kuzhinë me nënën e tij,*
- *ai preferon të jetë vetëm, të luajë lojëra, ose të shikojë filma vizatimorë ose dokumentarë, sesa të shoqërohet, ose*
- *ai shqetësohet vazhdimisht kur të tjerët flasin me zë të lartë ose kur shtyhen nëpër korridoret e shkollës*

Ekzistojnë ende shumë shembuj të familjeve tradicionale që nuk janë po aq të lumtur kur është lindur një vajzë, ashtu si kur është lind një djalë, megjithëse ata dinë të thonë: "Nuk ka rëndësi, vetëm të jetë fëmijë i

shëndetshëm". Disa prej tyre shpesh vendosin të kenë disa fëmijë derisa nuk u lind një mashkull, ndërkohë që nëna shpesh ndihet e pasuksesshme, sepse nuk e ka përmbushur pritjen për ta siguruar burrin e saj me një "pasues".

Jo shumë kohë më parë, vajzat nuk kishin të drejtë ta trashëgonin fare pronën, ose nëse kishin vëlla, motrat shpesh kanë hequr dorë nga pjesa e tyre në favor të vëllait të tyre. Sot, ky qëndrim, edhe kur nuk është i hapur, transferohet në marrëdhëniet me vajzën, sikur të ishte më pak e vlefshme, madje edhe para se të lindte.

Ushtrimi 1: Mohimi i normave negative gjinore

Nxënësit inkurajohen të japin argumente kundër shembujve të dhënë dhe pastaj të japin më shumë shembuj.

Kur kjo thuhet të jetë një fakt:

Çfarë mund të përgjigjen vajza/ djali kur mësojnë se si të kundërshtohen?

Futbolli nuk është për ty, nuk është për vajza (për vajzën 12 vjeçare)

Unë jam e mirë në futboll, vetëm unë dhashë gol në ndeshjen e fundit. Nuk është e drejtë të më ndalosh, mund t'ju ndihmoj të fitoni.

Vajzat duhet t'u ndihmojnë nënave të tyre, shko në kuzhinë dhe ndihmoji nënës me enët (për një vajze 14 vjeçare)

Edhe djemtë mund të ndihmojnë. Do të të ndihmoj pasi mbaroj me të mësuarit nëse kam kohë.

Pse po rri qetë? Pse mos godit një shuplakë, shiko sa i madh je, më i madh se ai. (për djalin 13 vjeçar)

Nuk dua të rrihem, do t'i them të mos bëjë ashtu më. Dhe do ta raportoj te nxënësi i detyrës, nëse vazhdon.

Vëllau yt duhet të vazhdojë me studimet, ti ke gjëra të tjera më të rëndësishme (për vajzën 17-vjeçare)

Jam nxënëse e shkëlqyer, të mësuarit më shkon mirë, edhe unë dua të vazhdoj me studime. Dhe nuk kam gjëra më të rëndësishme.

Djemtë nuk gatujnë, mos ji një froço¹⁷ (për një djalë 12 vjeçar)

Nuk jam froço, dua të mësoj të gatuj.

16 froço – për djem që duan të bëjnë punë të shtëpisë, në Shqipëri është marrë nga italishtja – froccio (shënim nga përkthyesja)

Në të gjitha këta shembuj, vajza duket sikur përgatitet për një marrëdhënie partneriteti, që pastaj të zgjedhë për pas edhe martesën si një mënyrë për të dalë nga roli i saj vartëse në familje, në vend që të inkurajohet për të zhvilluar aftësitë dhe besimin se mund të ketë sukses edhe në role të tjera. Në rastin tjetër, djali nuk mbështetet të jetë i ndryshëm - i ndjeshëm dhe i butë, dhe i interesuar për tema dhe përmbajtje që zakonisht nuk janë meshkuj.

Rezyme:

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të mësojnë të njohin dhe të përballen në mënyrë të sigurt me normat e dëmshme gjinore me qëllim që të krijojnë bashkësi të barabarta gjinore në familje, shkolla dhe vendin e punës.

Është përgjegjësia e të rriturve që t'u ofrojnë përkrahje fëmijëve të tyre në përpjekjet e tyre për qasje kritike ndaj roleve gjinore dhe të kuptojnë se ata janë të lirë për të kundërshtuar gjithmonë kur nuk përputhen me interesat, mundësitë dhe talentet e tyre.

PUNËTORI 5.

Miti dhe kundërshtimi i mitit

Miti është një ide, ose besim, e përhapur dhe e pranuar nga shumica, si një fakt, edhe pse nuk është e vërtetë. Për shkak të përdorimit të saj të përhapur, miti është i vështirë për të luftuar. Madje edhe më keq, kur norma arrin vlerën e një miti, shumë rrallë ndodh që dikush ta marrë në pyetje dhe ta problematizojë në mënyrë të argumentuar. Kështu, mitet e caktuara transferohen dhe mbijetojnë me gjenerata, pa ndonjë ndryshim ose ndërhyrje.

Për shembull: Vajzat janë më të butë se djemtë, dhe djemtë janë më të aftë se vajzat, janë vetëm disa nga ato mite për dallimet ndërgjinore.

Ushtrimi 1: Miti dhe argumentet kundër

Mitet për burrat dhe gratë

Argumente kundër mitit/ nga praktika dhe hulumtime

Gratë janë më të mira në kujdesin për familjen dhe fëmijët e tyre.

Djemtë janë më të zgjuar se vajzat.

Djemtë që qajnë janë të dobët.

Burri duhet të marrë vendime të rëndësishme në familje.

Djemtë nuk veshin veshje ngjyrë rozë dhe nuk luajnë me kukulla.

Burrat nuk janë në gjendje të mendojnë për disa gjëra në të njëjtën kohë.

Ushtrimi 1: Shembull i një MITI me norma të përcaktuara gjinore dhe me pasoja afatgjata:

Burri është i fortë dhe i paracaktuar për të mbrojtur gruan dhe familjen dhe për të fituar para për sigurimin e ekzistencës së tyre. Ai është më i fuqishëm se një grua, sepse ai është më i fortë, më i zgjuar dhe më i aftë, dhe gjithashtu ka më shumë kontroll mbi jetën e tij. Gruaja është e dobët, joshëse dhe e paqëndrueshme emocionalisht dhe prandaj duhet ta dëgjojë. Ajo është e paracaktuar dhe e aftë të lindë dhe të kujdeset për fëmijët dhe familjen.

Prejardhja

- Ndërsa vajzat luajnë me kukulla, për të cilat kujdesen në mini-shtëpi (nga lodrat) të pajisura me kuzhina, vegla dhe mobilje, për djemtë blihen makina, topa, armë, pistoleta. Fëmijët meshkuj janë më të favorizuar sesa femrat dhe kanë liri dhe mbështetje më të madhe në zhvillimin dhe interesat e tyre. Në të njëjtën kohë, ata janë më të mbrojtur, punojnë më pak, nuk janë të pavarur në kujdesin për vetveten dhe nuk nxiten të kujdesen për të tjerët, përveç në rolin e mbrojtësve. Nuk ia dalin më mirë në detyrat e shtëpisë, madje edhe kur duan të ndihmojnë. Ata rrallë e dinë, për shembull, ku qëndrojnë mielli, vaji, tualetet, qeset për mbeturina etj.
- Pritjet e tilla gjinore për djalin dhe vajzën, të krijuara nga kultura tradicionale, janë praktikuar me dekada, me ndryshime minimale që nënkuptojnë vetëm "rivendosjen" e zakoneve të vjetra në "roba moderne".

Efektet e

- Djemtë e kanë më të vështirë të përballohen me situata të reja, kanë pritshmëri të ndryshme dhe shpesh zhgënjehen më lehtë, kanë përqendrim më të dobët dhe sukses më
- të dobët në shkollë sesa vajzat. Ata janë më pak të sigurt në zgjedhjet e tyre dhe kur kanë tendencë të jenë të barabartë me vajzat, janë duke pritur që t'u jepet detyra për t'u përfshirë. Ndryshe nga ata, vajzat janë më të zellshme dhe të afta, por puna e tyre nuk vlerësohet në mënyrë të barabartë, përveç se në shkollë. Në shtëpi, puna që ato bëjnë është marrë për të dhënë; në vendin e punës/ kur ato rriten pozitat që i marrin, si dhe të ardhurat që i fitojnë, janë më të vogla se ato të një burri.
- Nëse një grua ka më shumë arsim dhe/ose ka pozitë më të lartë dhe/ ose fiton më shumë se sa burri, ai mund të ndihet keq, i papërshtatshëm dhe i pasuksesshëm.

Pasojat afatgjate

- Fuqinë që burri e fiton me rolin e tij, i lejon, në situata pakënaqësie personale, frustrimi dhe vuajtje, të vendoset ndaj gruas, në vend me respekt, me poshtërimet dhe fyerjet/ komentet ose me fjalë vulgare për pamjen dhe sjelljen e saj, madje edhe kur nuk e njeh atë grua, vetëm për shkak se ajo është një grua. Fuqia i lejon burrit që ai në mënyrë të dhunshëm të ndërhyjë dhe të pengojë në zgjedhjet dhe liritë e saj, gjithmonë kur nuk u është përgjigjur kërkesave/ pritjeve të tij për të cilat ai konsideron se e ka të drejtën, vetëm për shkak se është një burrë. Në situata të caktuara, ai mund t'i japë vetes të drejtën për ta abuzuar fuqinë e tij madje edhe me shqetësime seksuale, në kundërshtim me vullnetin e saj.

Kundërshtimi i elementeve të këtij miti dhe miteve të tjera mund të shndërrohet në një ushtrim për eksperimentim me pikëpamje dhe përvoja të reja. Për shembull, të futen pritje të reja, ose të ndryshohet rrjedha e ngjarjeve ose kontekstit, i cili vendos rregulla të reja.

Rezume për kundërshtimin të normave dhe miteve të dëmshme gjinore

Normat gjinore diskutohen në mënyrë të hapur, kritike dhe me kohë. Ka shumë mënyra për t'i kundërshtuar stereotipat dhe normat e dëmshme dhe të padrejta gjinore.

Përkundrazi, ato rriten në MITET, ose "kuazi të vërteta" që krijojnë qëndrime dhe kushte për atë që ËSHTË e mundur, dhe që NUK ËSHTË dhe/ ose është "normale" dhe e pranueshme, dhe çfarë është "anormale" dhe e papranueshme, si për shembull njerëzit me identitete atipike gjinore dhe seksualitet atipike.



Çfarë duhet të dinë nxënësit për t'i kuptuar më mirë normat gjinore?

Nxënësit duhet të dinë kuptimin e termave kryesore – gjinia, seksi, identitetin gjinor, orientimin seksual, dhe t'i kuptojnë konceptet e normave, roleve dhe identiteteve gjinore, që të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në diskutimin e çështjeve gjinore. Aty ku nocionet nuk janë mjaft të qarta ose janë plotësisht të reja për nxënësit, mësuesi duhet të jetë i hapur, i informuar sa duhet, por edhe i sigurt në vetvete, që t'i përgjigjet pyetjeve të tyre.

Nxënësit duhet të jenë në gjendje të njohin dëmet e normave të caktuara gjinore, dhe fuqinë e tyre kufizuese dhe diskriminuese në zhvillimin e të rinjve dhe perspektivat e tyre, pavarësisht nga gjinisë së cilës i përkasin. Nxënësit duhet të kenë mundësinë për të diskutuar se sa ata janë të drejtë dhe të barabartë dhe të mësojnë se kanë të drejtë t'i kundërshtohen pritjeve gjinore nëse ndiejnë se janë të padrejta ose të dëmshme.

Nxënësit duhet të njohin burimin e normave dhe pritjeve gjinore. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm se karakteret e tyre të preferuar nga librat dhe revistat, këngëtarët idhujt apo personazhet e serive tuaj të preferuara televizive, se të gjithë ata me sjelljen e tyre, pamjet dhe qëndrimet e tyre pasqyrojnë normat e caktuara gjinore të cilat të rinjtë i ndjekin shpesh. Nxënësit duhet të dinë se si të parashtrojnë pyetje kritike se pse këto persona/ sjellje u pëlqejnë, dhe nëse dhe si ata ndikojnë në forcimin e pritjeve negative gjinore, ose nëse ata mund të përmbajnë potencial për të ndryshuar pritjet negative gjinore.

Kundërshtimi i normave dhe miteve të dëmshme gjinore. Nxënësit duhet të jenë të lirë që t'i hulumtojnë këto çështje (normat, mitet dhe stereotipat gjinorë), dhe kur do t'i dallojnë ose do t'i ndiejnë si të padrejtë, të dinë se mund t'i kundërshtojnë madje edhe në rastet kur ata duken aq "natyrorë" dhe "normalë" për mjedisin. Sidomos për shkak se ata shpesh janë prezantuar përmes mesazheve të dyfishtë "shqetësueso-kërcënuese" të cilave nganjëherë nuk është e lehtë për t'iu përgjigjur.

- Nëse mbetesh e tillë (rebelë, ambiciozë), askush nuk do të martohet me ty.
- Nëse pret dhe përzgjedh shumë, do të mbetesh e pamartuar.
- Djemtë kurrë nuk ankohen, ata nuk kanë frikë nga asgjë.

- Materniteti është roli më i rëndësishëm në jetën e një gruaje.
- Gruaja është e detyruar ta dëgjojë burrin, sepse ai po lufton për të gjithë familjen.
- Burri di më mirë sesa gruaja se çfarë është më e mira për gruan sepse ajo është e hutuar, e humbur, shumë emocionale.

Nxënësit duhet të mësojnë të njohin mitet që funksionojnë si "fakte", duke menduar në mënyrë kritike dhe të arsyeshme. Ata duhet të bëhen të vetëdijshëm për "rezistencën" e mitit dhe për këmbënguljen e tij për t'u mbështetur për çdo çmim, shpesh dhe shumë të lartë. Te miti ata duhet ta dallojnë "instrumentin e kontrollit", i cili nuk është i lehtë për t'u mësuar. Dhe të kërkojnë shembuj (nga praktika ose nga literatura) me të cilat gjithmonë do ta "thyen" mitin në të vërtetën e tij të rreme.



Rekomandime për arsimtarin

Mësimdhënësi duhet t'u referohet fakteve (nga hulumtime) në informacionet, komentet dhe konkluzionet e tij. Ai/ ajo duhet të ketë vetëbesim, të jetë në gjendje për të udhëhequr dhe të ndërmjetësojë pa i imponuar pikëpamjet e veta personale dhe të dijë të dëgjojë dhe t'i respektojë mendimet e nxënësve, edhe kur me pikëpamjet e tyre nuk pajtohet. Pikërisht këto dallime mund të jenë pjesë e kulturës së normuar që u imponohet të rinjve dhe për të cilën duhet qasje dhe aftësi të ndryshme, për ta ndryshuar.

Mësimdhënësit duhet sillen ndaj nxënësve si pjesëmarrës të barabartë në diskutim. Kjo do t'i inkurajojë ata që të përdorin njohuritë e tyre dhe të kontribuojnë në kërkimin dhe diskutimin e roleve dhe pritjet të tyre, si dhe për veçoritë që zakonisht u janë atribuar dhe i përkufizojnë ndryshe.

Mësuesi duhet të jetë njeri i besueshëm për nxënësit. Vetëm në këtë mënyrë ata do të fitojnë besimin e nevojshëm për përfshirje aktive në diskutimin e temave të ndjeshme që më pas të diskutojnë në mënyrë kritike për rolet dhe stereotipat gjinore, shumica e të cilave tashmë i kanë pranuar edhe vetë ata.

Mësuesi duhet të jetë në gjendje të prezantojë dhe të udhëheqë nxënësit nëpër procesin e të menduarit kritik - duke treguar vendet (në media, letërsi, tekste) që favorizojnë stereotipat gjinorë, duke treguar fuqinë e tyre manipuluese dhe diskriminuese. Ai/ ajo duhet t'i kushtojë vëmendje

ndikimit të mediave mbi mendimet, pritjet dhe veprimet e të rinjve në raport me personin tjetër.

Mësuesi duhet të jetë i përgatitur në qoftë se nxënësit nuk do të heqin dorë nga besimet dhe pozitat e tyre, dhe i trajtojnë si fakte, që të ofrojë shembuj të grave/ burra të famshëm që me rolin, suksesin dhe pozitën e tyre me sukses i janë përballuar mitit. Gjithashtu, mësuesi duhet të potencojë se dallimet brenda vetë grupit gjinor (burra ose gra) mund të jenë aq më të mëdha sesa dallimet midis gjinive të ndryshme.

TEMA 2:

Si të arrijmë barazi gjinore nëpërmjet modeleve pozitive gjinore?

Përdorimi i modeleve pozitive gjinore në trajtimin e stereotipeve gjinore është në fuqinë e tyre dhe aftësinë për të nxitur, udhëhequr dhe mbështetur ndryshimet

PUNËTORI 1:

Njohja e modeleve pozitive gjinore

Roli i modeleve pozitive gjinore në trajtimin e stereotipave gjinorë është në fuqinë dhe aftësinë e tyre për të iniciuar, udhëhequr dhe mbështetur ndryshimet. Prandaj, ideja për identifikimin me modelet gjinore lidhet me cilësitë e njeriut që shkakton admirim midis të rinjve, veçanërisht me sjelljen e tij me drejtësinë, qëndrueshmërinë dhe me respekt ndaj të tjerëve.

Ushtrimi 1: Stuhi e ideve

Nxënësit duhet të mendojnë për një person që e admirojnë, të mendojnë për cilësitë e tij më të mira dhe ta përshkruajnë me tri fjalë. Një fletë e madhe shënohen shembujt e dhënë nga i gjithë grupi. Në fund përmbliiden tiparet e përbashkëta dhe konkludohet se ato tipare zakonisht nuk përcaktohen nga gjinia.

Ushtrimi 2: Potencialet e karakteristikave personale

Nxënësve (në grupe të vogla) u jepet një listë e përshkrimeve të caktuara të cilësive personale (Tabela 3), prej të cilave ata zgjedhin disa dhe shpjegojnë se çfarë nënkuptojnë dhe si manifestohen në praktikë.

Mësuesi thekson se ne zakonisht zgjedhim tiparet që edhe vet ne i kemi ose duam të shohim në vetveten dhe se ato janë një potencial i madh personal që mund të shfrytëzohet. Po ashtu që çdo person ka fuqinë dhe cilësitë pozitive që ai duhet të përpiqet të zbulojë dhe të përdorë.

Ushtrimi 3: Karakteristikat që i çmojmë te të tjerët

Nxënësit bëjnë një përzgjedhje të karakteristikave që do të ishte e dëshirueshme që anëtarët e një bashkësie t'i posedojnë që kjo bashkësi të jetë e drejtë, nxitëse dhe e sigurt për të gjithë anëtarët.

Pastaj ata diskutojnë për atë që është e nevojshme për të rriturit (prindërit, mësuesit) dhe si ata mund t'i frymëzojnë për të qenë më të mirë, për t'i respektuar dhe ndjekur.

Ushtrimi 4: Karakteristikat që bëjnë të jemi model për sjellje për të tjerët

Nxënësit duhet të mendojnë se cilat janë ato tipare me anë të të cilave vetë ata mund të jenë modele për më të rinjtë dhe se si ata mund t'i përdorin nëse ata do të bëheshin mentorë të tyre (në çfarë mund t'i ndihmonin dhe t'i udhëzonin).

Mësuesi si një model për ndjekje - Nxënësit janë në gjendje të njohin se me kë, midis mësuesve, ata mund të krijojnë marrëdhënie pozitive. Në përshkrimet e tyre, mësuesit e preferuar zakonisht paraqitet si person i mirë, i organizuar, i qëndrueshëm, i rreptë, por në mënyrë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë. Nxënësit mësojnë duke vëzhguar qëndrimet dhe veprimet e mësuesve, si dhe stilin e tyre të mësimdhënies dhe vlerësimit. Një mësues që pëlqehet nga studentët mund të bëhet një model gjinor pozitiv për ta.

Tabela 9: Karakteristikat në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive me të tjetrin/ tjetrën

<p>I kujdesshëm Bën gjëra për të tjerët pa pritur asgjë në këmbim</p>	<p>I guximshëm Bën atë që e di se është mirë, edhe kur është i frikësuar ose nervoz</p>	<p>I drejtë Siguron që të gjithë të vijnë në radhë dhe i respekton rregullat</p>
<p>Lider Ofron ide dhe sugjerime për të ndihmuar grupin</p>	<p>Bujar Ndan me të tjerët atë që ai ka dhe u lejon atyre të marrin pjesë në lojën</p>	<p>Zemërbutë I kalon shpejt zemërimi dhe lëndimi, kur dikush e zemëron ose e ofendon</p>
<p>Humor Bën shaka, dëshiron të qeshë dhe dëshiron që të tjerët të qeshin</p>	<p>Vetëkontroll I kontrollon ndjenjat e tij të forta, edhe pse i vjen për të bërtitur</p>	<p>Kureshtar Dëshiron të zbulojë dhe është i lumtur kur mëson për gjëra të reja</p>

Rezyme mbi fuqitë dhe potencialet për ndryshim

Çdo person ka pikat dhe cilësitë e forta, pavarësisht nga gjinia e tij/saj.

Ne vetë zgjedhim se cilët njerëz dhe për cilat vlera dhe cilësi duam t'i ndjekim si modele.

Tiparet dhe vlerat pozitive të karakterit mund të përdoren për të ndërtuar një bashkësi të respektueshme dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë.

PUNËTORI 2:

Drejtësia, barazia dhe të drejtat e njeriut

Kombet e Bashkuara janë një organizatë e themeluar për t'u kujdesur për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve dhe grave në mbarë botën. Të drejtat e njeriut/ fëmijëve u përkasin të gjithë njerëzve sepse ata janë qenie njerëzore. Me lindjen, fëmija dhe njeriu fitojnë të drejtat e veta për zhvillim dhe jetë dinjitoze, të barabartë dhe të sigurt. Kjo është arsyeja pse ne nuk themi se dikush i jep ose mund t'i marrë të drejtat e njeriut. Në raste të jashtëzakonshme, e drejta për liri, në kohë dhe në rrethana të caktuara, mund të jetë e kufizuar.

Deklarata për të Drejtat e Fëmijës është një dokument i veçantë që garanton të drejtat e të gjithë fëmijëve në botë, pavarësisht prej përkatësisë ose vendndodhjes së tyre. Thelbi i të drejtave të fëmijëve përbëhet nga: e drejta për jetë dhe zhvillim, e drejta për mosdiskriminim dhe e drejta për pjesëmarrje. Ky është themeli për të gjitha të drejtat e tjera.

Ushtrimi 1: Krijimi dhe mbrojtja e botës ideale

Prej nxënësve (në grupe të vogla) kërkohet të imagjinojnë se si do të duket bota ideale - paqësore, e sigurt dhe e drejtë për të gjithë banorët e saj. Sipas përshkrimeve të tyre, nxënësit (në çifte) inkurajohen të marrin në konsideratë se cilat rregulla dhe pritshmëri duhet të prezantohen dhe të respektohen, për atë botë që të ekzistojë?

Pastaj duhet t'i përzgjedhin pesë rregullat më të rëndësishme që do të garantonin kushte të barabarta për të gjithë, pavarësisht nga gjinia dhe dallimet e njerëzve.

Mësuesi përfundon se për një kohë të gjatë (për disa dekada) njerëzit kanë menduar për kushtet për një jetë të drejtë dhe dinjitoze për të gjithë njerëzit në botë, si dhe për rregulloret në zbatimin dhe qëndrueshmërinë e këtyre kushteve.

Deklarata për të Drejtat e Fëmijës, së bashku me Konventa për eliminim të të gjitha formave të diskriminimit mbi gratë, si dhe Konventa e Stambollit

kundër dhunës ndaj grave¹⁷, janë dokumente ndërkombëtare, të miratuara nga vendet t shumta, ndër të cilave edhe Maqedoni. Praktikisht, ato dokumente janë grumbullim i kushteve dhe pritjeve të vendosura dhe garantuara nga të gjitha vende anëtarë, në përpjekjet që çdo njeri të trajtohet në mënyrë të barabartë, me dinjitet dhe respekt.

Nga mosha më e hershme, nxënësit duhet të njihen dhe të mësojnë se si të ushtrojnë të drejtat e tyre. Që të mund të diskutojnë për të drejtat në mënyrë të argumentuar, dhe pastaj që të mund t'i prezantojnë dhe mbrojnë këto të drejtat, ata duhet të dinë se si të njohin (pa)drejtësinë, ose kushtet e (pa)drejta të jetesës të çdo personi, pavarësisht nga gjinia apo çdo përkatësi tjetër, në çdo mjedis - familje, shkollë, punë dhe jashtë institucioneve, dhe kanë për detyrë dhe përgjegjësi t'i mbrojnë në mënyrë aktive.

Për të kuptuar më mirë të drejtat e fëmijëve, nxënësit mund t'i diskutojnë dhe t'i dallojnë duke i vënë ato në kontekste të ndryshme, siç është familja, shkolla, vendi i punës. Rritja e vetëdijes për të drejtat e njeriut dhe trajtimi i njeriut me respekt dhe vëmendje të barabartë zvogëlon mundësinë e ndarjes dhe diskriminimit mes gjinive.

Rezume mbi të drejtat e njeriut

Nxënësit duhet t'i dinë të drejtat e tyre dhe të mësojnë t'i përdorin dhe t'i mbrojnë.

Njerëzit dhe fëmijët mund dhe duhet të marrin pjesë në krijimin e një bote më të drejtë për të gjithë.

Nxënësit mund të punojnë mbi vendosjen e kushteve dhe rregullave me të cilat do t'i mbrojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve në komunitet/ shkollë.

Të drejtat e njeriut janë mjete që u kujtojnë njerëzve se çdo person duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë, me respekt dhe dinjitet

17 Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunë në familje nga 11.5.2011, e njohur si Konventa të Stambollit, është një dokument i rëndësishëm ndërkombëtar. Konventa është nënshkruar nga 120 vende, ndër të cilave edhe Maqedonia (2017)

PUNËTORI 3:

Fuqia, llojet dhe mënyrat e përdorimit të fuqisë

Fuqia përcaktohet si kapaciteti i një individi për të ndikuar mbi të tjerët, dhe/ ose mbi atë që po ndodh. Ajo (fuqia) lidhet me (jo)respektimin dhe (jo) ushtrimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, por edhe me mundësitë për keqpërdorimin e saj të lehtë në marrëdhëniet ndërgjinore, më së shpeshti mes burrit dhe gruas, por edhe më gjerësisht.

Ushtrimi 1: Lojë e pushtetit dhe kontrollit

Nxënësit luajnë lojë "robot-kontrollues", kështu që ata qëndrojnë njëri përballë tjetrit. Kontrolluesi mban dorën e tij në lartësinë e hundës/ ballit të robotit, i cili duhet të monitorojë lëvizjet e dorës së kontrolluesit, duke lëvizur kokën dhe trupin. Nxënësit ndryshojnë rolet dhe diskutojnë se si ndihen në të dyja role, kur kanë fuqi të pakufizuar (të bëjnë gjëra dhe të udhëheqin) dhe kur vetëm kryejnë detyra.

Mësuesi thekson se si posedimi i pushtetit mund të bëjë që njeriu të dëshirojë ta zgjerojë dhe ta përdorë pushtetin mbi të tjerët pa e vënë re se ai po abuzon me të. Fuqia e bën personin të pandjeshëm ndaj faktit se ai, nëpërmjet asaj fuqie, mund të marrë plotësisht kontrollin e gjërave dhe të diktojë cilësinë e jetës së personit tjetër.

Format nëpërmjet të cilave mund të manifestohet fuqia janë gjithashtu të ndryshme: si kontroll mbi gjërat ose personat (për shembull, kontrolli i prindit mbi fëmijën, që mund të jetë kufizuese, por gjithashtu stimuluese dhe e dobishme); fuqia e jashtme/ e përbashkët (fuqia që vjen nga përkatësia në një ide, grup, iniciativë të përbashkët); dhe fuqia e brendshme, e cila rrjedh nga njohuritë, burimet, pozicionet, mosha, mirëqenia e vetë, e kështu me radhë. Të gjitha këto forma mund të nënkuptojnë përdorimin pozitiv dhe/ ose negativ të fuqisë.

Në përdorimin e fuqisë është me rëndësi të shohim se çfarë mund të ndikojë në prodhimin dhe mirëmbajtjen e fuqisë së njerëzve - para, pozita, miqtë dhe lidhjet shoqërore, energjia, popullariteti, madhështia, njohuria, aftësia, dhe se si ata ndryshohen me ndryshimin e kushteve. Dhe çfarë privilegjesh njerëzit fitojnë me fuqinë, për shkak të të cilave nuk e kanë të lehtë të heqin dorë nga ajo.

Ushtrimi 2: Llojet e fuqive

Nxënësit diskutojnë se cilat lloje të pushtetit ekzistojnë: pozitive dhe negative, të brendshme, të jashtme etj., prej çfarë varet dhe si fuqia ndryshon në varësi të rrethanave.

Për shembull, si ndryshon/ rritet ose zvogëlohet fuqia nëse ndryshohet konteksti, ose pjesëmarrësit në të, mosha e protagonistëve ose nëse futet kontrolli i jashtëm.

Është e rëndësishme të theksohet se njerëzit me pushtet nuk kanë vetëm pushtetin, por edhe përgjegjësinë për ta përdorur atë në komunikimin me të tjerët, duke respektuar të drejtat e tyre. Pra, për të kontrolluar fuqinë, përveç vetëkontrollit, nevojiten mekanizma të fuqishëm të kontrollit të jashtëm si rregulla, rregullore, ligje, politika, organe etj.

Rezyme mbi fuqinë, llojet e fuqisë dhe rreziqet e (keq) përdorimit të saj

Njerëzit mund të përdorin fuqinë e tyre në mënyrë pozitive dhe negative.

Ka shumë lloje të fuqisë – pushtet mbi dikë apo diçka; fuqia së bashku me person ose grup tjetër për një ide, vendosmëri etj.; ndjenjën e brendshme të fuqisë.

Marrëdhëniet ndërmjet njerëzve janë nën ndikim të fortë nga ndjenja e ndërsjellë e fuqisë.

Fuqia është kategori e ndryshueshme, varësisht nga: gjinia, mosha, pozita, arsimit, mirëqenia dhe të gjitha këto forma varen nga konteksti i zbatimit.

Njerëzit me kontroll mbi gjërat ose mbi dikë janë përgjegjës për mënyrën e përdorimit të fuqisë së tyre, a do ta abuzojnë ose do të kontribuojnë për ndryshime pozitive.

PUNËTORI 4.

Dallime dhe diskriminim

Diskriminimi është një trajtim i padrejtë i një personi ose i një grupi njerëzish, për shkak të gjinisë së tyre ose përkatësisë etnike, fetare etj., për shkak të pozitës së tyre shoqërore ose për shkak të disa karakteristikave të tyre personale. Subjektet e diskriminimit janë njerëzit, ose grupet me fuqinë më të vogël në shoqëri, dhe këta janë njerëzit më të pambrojtur dhe më të marginalizuar dhe prandaj shpesh të padukshëm në shoqëri.

Ushtrimi 1: Shembuj të diskriminimit

Nxënësit duhet të tregojnë disa grupe/ individë të cilët janë të diskriminuar në shoqëri, te ne dhe në botë, të cilët nuk gëzojnë të drejta njësoj si të tjerët, dhe pastaj të diskutojnë për bazat e diskriminimit dhe pse kjo po u ndodh këtyre njerëzve/ grupeve.

Ushtrimi 2: Pabarazia në diskriminim

Përgjatë vazhdimësisë së diskriminimit, e përfaqësuar me një vijë imagjinare (në dyshemenë e dhomës/klasës), nxënësit janë të ftuar të vendosin fletë me emrat e disa individëve dhe/ ose grupeve, nga pika më e ulët deri në pikën më të lartë në shkallën e diskriminimit dhe pastaj diskutojnë për pozitën e tyre që të mësojnë se ka shkalla të ndryshme të cënueshmërisë dhe marginalizimit për anëtarët e grupeve të ndryshme të shoqërisë. Disa janë të diskriminuar në disa baza, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuar të prindërve të papunë, të rinjtë LGBT në mjedise homofobike, gratë apo nënat e vetme në strehimore për refugjatët dhe kështu me radhë.

Mësuesi duhet të shpjegojë se njerëzit më shpesh diskriminojnë për shkak të mungesës së informacionit, keqinformimit, frikës së pabazë dhe për shkak të ndjenjës se tjetri është i ndryshëm nga ne, si dhe për shkak të mosnjohjes dhe mosrespektimit të të drejtave të njeriut. Për ta tejkaluar pozitën së dikujt që gjykon dhe stigmatizon, nxënësit janë nxitur të informohen më mirë dhe t'i përmirësojnë aftësitë e komunikimit me të tjerët që janë të ndryshëm.

Për stigmën në lidhje me gjininë dhe seksualitetin – flasim kur grupe të caktuara të njerëzve përjetojnë diskriminim të rëndë për shkak të gjinisë së tyre apo orientimit seksual.

Në shumë vende, por jo kudo në mënyrë të barabartë, gratë janë më të ekspozuar ndaj diskriminimit dhe kanë mundësi të kufizuar në krahasim me meshkujt. Rolet e definuar gjinore dhe plotësimi i tyre në mënyrë rreptësisht të përcaktuar, në disa kultura e zmadhojnë diskriminimin ndaj grave.

Ushtrimi 3: Diskriminimi ndaj një gruaje tradicionale

Prej nxënësve kërkohet të mendojnë dhe të tregojnë se ku gratë diskriminohen në shoqërinë tonë.

Shembujt që mësimdhënësi mund t'i nxjerrë nga nxënësit janë: pozicioni vartës dhe vendi që "i është caktuar" gruas në shtëpi, në vendin e punës dhe në marrëdhëniet me të tjerët; mosbesimi në aftësitë dhe cilësitë e saj; nënçmimi i arritjet e saj, kornizat e ngushta për realizimin e mundësive, talenteve dhe ambicieve të saj; imazhi i trupit të saj si subjekti kënaqësie ose riprodhimit; minimizimi i interesave dhe aftësive të saj vetëm "për t'u kujdesur" dhe "për të kënaqur" interesat dhe nevojat e të tjerëve (fëmijët, burrin, shefin) përpara interesave personale.

Një bazë tjetër për diskriminim është edhe stigmatizimi i orientimit seksual të njeriut, i shprehur si tërheqje emocionale dhe/ose seksuale ndaj anëtarëve të seksit të kundërt (heteroseksualë), i njëjti seksi (homoseksualë), dhe /ose të dy sekseve (biseksual).

Një grup shumë i diskriminuar janë edhe të rinjtë transgjitorë, si dhe të gjithë rinjtë e tjerë me përkatësi atipike gjinore, për të cilët mësuesi i informon nxënësit, tani në aspektin e ndjeshmërisë më të madhe se si ata trajtohen nga mjedisi që nuk i kupton, dhe për shkak të asaj - i marginalizon. Ndjenja e përkatësisë gjinore është një ndjenjë komplekse dhe në formimin e saj përfshihen shumë faktorë - sociale, gjenetike, fiziologjike, kulturore. Për shembull, identiteti gjinor lidhet me ndjenjat e thella subjektive të përkatësisë gjinore që shfaqen që nga mosha e re. Hulumtimet më të fundit¹⁸ mbi njerëzit transeksualë tregojnë përparim në zbulimin e

18 Boston University Medical Center. "Transgender: Evidence on the biological nature of gender identity" Science Daily, 13 February, 2015

aktiviteteve nervore në zonat e trurit, të cilat konsiderohen të jetë një përgjigje e mundshme për ndjenjën e përkatësisë gjinore, dhe të cilat aktivohen që në periudhën para lindjes, por jo gjithmonë e ndjekin formimin e seksit biologjik të fëmijës.

Domethënë, seksi biologjik është përcaktuar nga struktura dhe numri i kromozomeve (x, y), me mbështetje të gjëndra hormonale dhe formimin e karakteristikave trupore seksuale të djali/ vajza, me që identifikohet seksi biologjik i fëmijës në lindje. Për shkak të mospërputhjes së seksit të fëmijës me ndjenjën gjinore, djemtë/ vajzat transeksuale e perceptohen vetveten si me gjini joadekuate dhe sikur janë të huaj në trupin e vet. Ky shqetësim bën që ata vazhdimisht të tentojnë të vërtetojnë se kush dhe çfarë janë, në fakt.

Mësuesi duhet t'i informojë nxënësit me anë të studimeve të rastit, për stigmën e "jonormalitetit" ose "gabimit të natyrës" me të cilët janë detyruar të jetojnë njerëzit transgjinorë dhe me të cilët, nga mosha më e re, ata përpiqen të luftojnë kundër të gjithë të tjerëve (anëtarët e familjes, bashkëmoshatarët, shokët e klasës dhe tërë komuniteti). Dhe që e vetmja gjë që ata e dinë për vetveten është rezistenca që e japin kundër presioneve të larta që t'i braktisin "idetë" për identitetin e tyre gjinor, i cili në vetvete është kaotik dhe ata vetë e kanë të vështirë për ta kuptuar.

Një grup tjetër shumë i diskriminuar/ stigmatizuar janë personat ndërseksualë - të lindur me anatomi atipike seksi, e cila ndryshon nga trupat e determinuara biologjikisht si trup mashkullor ose femëror. Biologjikisht ata nuk janë as plotësisht meshkuj, as plotësisht femra. Këta njerëz nuk janë të sëmurë, ata janë thjesht të ndryshëm sepse janë të lindur ashtu. Injoranca dhe keqkuptimi janë arsye më të zakonshme për stigmatizimin dhe diskriminimin e fortë ndaj këtyre njerëzve. Njerëzit ndërseksualë janë nën presion të vazhdueshëm për të ndryshuar, nuk janë pranuar dhe janë izoluar, jetojnë me turp për arsyen që janë të ndryshëm, në vend që të pranohen dhe të jenë krenarë ashtu siç janë.

Përfundim mbi diskriminimin dhe stigmatizimin

Disa njerëz trajtohen keq dhe padrejtësisht vetëm për shkak të përkatësisë së tyre - përkatësia gjinore, kombëtare, kulturore, fetare, seksuale ose për shkak të karakteristikave të tjera personale.

Diskriminimi shkakton dëme të menjëhershme dhe afatgjatë, sepse parandalon disa njerëz/ grupe të kenë mundësi të barabarta për zhvillim dhe për të ndjerë të sigurt, të përfshirë dhe të respektuar në bashkësinë ku jetojnë.

Diskriminimi me bazë gjinore është një pasojë e abuzimit të pushtetit mbi grupe apo individë (gratë, homoseksualët, personat transgjinorë, personat ndërseksualë etj.) vetëm për shkak të identitetit të tyre gjinor apo orientimit seksual.

Mbështetësit, dëshmitarët dhe/ ose vëzhguesit të aktit të ngacmimit dhe dhunës, luajnë rol në përgjegjësinë për ruajtjen dhe thellimin e diskriminimit: pjesëmarrës të drejtpërdrejtë (nëpërmjet gjuhës së urrejtjes, kërcënimeve, nxitjeve dhe sulmeve) dhe indirekte (nëpërmjet pranisë së tyre pasive dhe hezitimi për ta parandaluar atë).

PUNËTORI 5:

Udhëheqësit në reduktimin e diskriminimit gjinor

Ushtrim 1: Karakteristikat e udhëheqësve

Të rinjve u jepen tre skenarë që përshkruajnë veprimet e bashkëmoshatarëve të tyre në situata të caktuara, përmes të cilave ata duhet të nxjerrin karakteristikat kryesore të personalitetit të tyre.

Lena

Duke u kthyer nga shkolla, Lena prapa oborrit të shkollës pa se katër djem janë duke tërhequr nga shpina dhe duke goditur një djalë i cili nuk mund të mbrohej ose të shpëtohet. Ajo ndaloj dhe i pa ata, dhe njëri prej djemve iu drejtua me fjalët vulgare: "Çka, do edhe ti një rrahje?" Ajo përgjigjet: "Nuk duhet ta rrihni djalin." Dhe pastaj vazhdon shpejtë në dyqanin e afërt, në 10 metra nga shkolla, dhe kërkon ndihmë nga punonjësit. Shokët e dinë se ajo është gjithmonë miqësore dhe të gatshme për të ndihmuar të tjerët. Ajo ka një vëlla më të madh dhe ai shpesh e shoqëron deri në hyrjen e shkollës. Kur ka ndonjë padrejtësi në vlerësimin dhe notimin e shokëve të klasës, ajo gjithmonë kërkon shpjegim. Gjithashtu, ajo kërkon shpjegime kur diçka është e paqartë ose nëse dëshiron të zbulojë më shumë në ligjëratë. Njerëzit thonë për Lenën se gjithmonë bën si "Kalimero".

Metin

Ka shumë shokë, ndër të cilët edhe disa për të cilët thonë se janë problematikë. Ai është gjithmonë i afrueshëm dhe i sjellshëm, dhe nganjëherë e tallin për shkak të kësaj. Ai ka ndjenjë të mirë humori dhe njerëzit e duan. Por kur disa djem nga lagja e tij sulmuan një djalë rom, dhe djali rom nuk mundi të vijë në shkollë të nesërmen, Metin atë e mori me shumë seriozitet. Ai organizoi disa shokë dhe shkuan për ta vizituar shokun e sulmuar, dhe gjithashtu bisedoi me prindërit e tij për ngjarjen. Pastaj ai shkroi një tekst të shkurtër për dhunën dhe teksti u lexua publikisht në shkollën e tij. Në tekstin ai shkroi se dhunuesit duhet të zbulohen dhe dënohen. Pastaj, rregullisht informonte për gjendjen e shokut të tij, formoi një grup mbështetës dhe veprimet e tij u pritën me mbështetje të madhe nga të gjithë në shkollën.

Drita

Dritoni doli shumë i guximshëm, kur pas vitit të parë në shkollën e mesme, në të cilën vazhdimisht ishte ngacmuar dhe përndjekur për shkak të paraqitjes dhe sjelljes e tij si një vajzë (sepse ishte një person transgjinor), kur kërkoi prej prindërve dhe pastaj edhe prej shkollës ta ndryshojë emrin e vet në Drita dhe ta vazhdojë jetën si vajzë. Me mbështetjen e prindërve dhe drejtorit të shkollës, Drita mori dokumente të reja, ndërsa mësuesit dhe prindërit e fëmijëve nga klasa e saj pasi u informuar plotësisht, ranë dakord ta përkrahin plotësisht rolin e saj "të ri" gjinor. Por kjo nuk ishte gjithmonë e lehtë për Dritën. Përkundrazi, ajo duhej të jetë edhe më të guximshme se më parë dhe e kishte më e vështirë për të ndjekur ambiciet dhe nevojat e saj, dhe jo të gjithë i kuptuan ato nevoja. Megjithatë, pengesat që i përballoi në çdo hap dhe që me mundje i tejkaloi, e bënë që të jetë madje më e fortë, kurse bashkëmoshatarët e saj në fund e mirënjohën përkushtimin dhe guximin e saj për të luftuar për atë që është.

Udhëheqja konfirmohet me ndërtimin e vlerave pozitive, me sjellje miqësore në grupin e kolegëve, por edhe me largim nga nënçmimet, ngacmimet dhe të gjitha format e tjera të dhunës kundër individëve (nxënësve) dhe grupeve të veçanta.

Rezime mbi udhëheqjen midis nxënësve

Sjellja e përditshme miqësore dhe mbështetja e të tjerëve shpesh mjaftojnë për të njohur individin si dikë që nuk pranon diskriminim dhe dhunë kundër të tjerëve.

Aftësitë e lidërsipit zbulohen nëpërmjet miqësisë dhe dashamirësisë ndaj anëtarëve të grupeve të cenueshme, por edhe nëpërmjet kundërshtimit të hapur dhe me zë të lartë ndaj çdo akti diskriminimi.



Çfarë duhet të dinë nxënësit për barazinë dhe modelet pozitive gjinore?

Nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për cilësitë e njerëzve të cilët admirojnë dhe të shohin se ato cilësi nuk varen nga përkatësia gjinore (të tilla si guximi, drejtësia, ndërlidhshmëria, urtësia, humori etj.). Cilësitë e njëjta kryesisht i posedojnë edhe vetë ata, por duhet të mësojnë se si t'i përdorin dhe t'i shndërrojnë në rregulla dhe pritshmëri dhe së bashku të ndërtojnë një ambient shkollor pozitiv, të drejtë dhe të sigurt.

Nxënësit duhet të dinë për të drejtat e njeriut/ fëmijëve dhe të mësojnë për ato duke shkëmbyer perceptimet e tyre se çfarë është një shoqëri e drejtë. Ata duhet të njihen me deklaratat dhe konventat e organizatave të OKB-së, dhe t'i perceptojnë si grumbullim të rregullave dhe pritjeve, të miratuara nga qeveritë e shumë vendeve, ku në pozitën më të lartë janë vendosur të drejtat e jetës, të mësuarit dhe zhvillimit, si dhe të drejtat mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes, si bazë për ndërtimin e shoqërive të ndershme.

Është mirë që nxënësit të bëjnë dallimin midis përdorimit pozitiv të fuqisë (kur burimet, aftësitë, veprimet dhe ndikimet e veta janë përdorur për të mirën e të tjerëve), dhe në anën tjetër – abuzimi i fuqisë, kur merret kontroll mbi gjërat apo njerëzit për përfitime personale, pa kujdes se si do të ndikojë në jetën e të tjerëve dhe komunitetit. Nxënësit duhet të shohin se si niveli i fuqisë ndryshohet në varësi të kushteve të cilat gjithashtu janë të ndryshueshme: pozita, mosha, pushteti, konteksti, marrëdhëniet me të tjerët dhe kështu me radhë.

Nxënësit gjithashtu duhet të bëhen të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre në përdorimin e fuqisë, por edhe për nevojën e mekanizmave të jashtëm për kontrollin e saj.

Njerëz/ grupe të ndryshme mund të diskriminohen në shkallë të ndryshme dhe në bazë të ndryshme. Një shembull janë njerëzit LGBT në Maqedoni dhe Evropë, madje edhe në zonat e zhvilluara, ku grupe të caktuara vulnerabil (romët, refugjatët) jetojnë (në dukje) në mënyrë të sigurt dhe me të drejta të barabarta, ata janë të diskriminuar dhe nuk kanë të njëjtat mundësi me qytetarët e tjerë.

Nxënësit duhet t'i dallojnë format e dukshme (stigmatizimi, përjashtimi, dhunës) dhe format e fshehura të diskriminimit (nëpërmjet masave mbrojtëse dhe rregullat kufizuese, apo ligjet që nuk janë zbatuar). Ata gjithashtu duhet t'i dallojnë format e pozicioneve të shumëfishta

diskriminuere të grupeve dhe/ ose individëve të caktuar, të cilat vuajnë nga padrejtësi të shumëfishta në të njëjtën kohë.

Nxënësit duhet të dinë për numrin e madh të formave diskriminimit gjinor dhe seksual: stigmatizimi i grupeve të transeksualëve, homoseksualëve, biseksualëve, njerëzve ndërseksualë, ndaj të cilëve duhet zhvilluar marrëdhënie respekti, gjithëpërfshirjes dhe tolerancës zero ndaj dhunës në shkolla dhe më gjerë. Ata duhet të dinë t'i njohin këta të rinj dhe t'i përkrahin në barazi dhe në përpjekjet e tyre për të ushtruar të drejtën e tyre për identitetin gjinor.

Nxënësit duhet të dinë se karakteristikat kryesore të udhëheqësve në luftën kundër diskriminimit janë guximi për të vepruar në përputhje me vlerat personale, respektimi i tjetrit/tjetrës dhe ndërmarrja e aksioneve për ta zvogëluar stigmatizimin në jetën e përditshme të të rinjve në shkollë.

Nxënësit duhet ta dinë kanë përgjegjësi personale kur zënë ndonjë anë për ose kundër të drejtave të grupeve/ individëve të marginalizuar dhe të diskriminuar. Ndihma në marrjen e përgjegjësive personale ofrohet nga të rriturit (prindërit, mësuesit) me informimin në kohë dhe me zhvillim të aftësive komunikimi, si dhe me tejkalim të dallimeve, nëpërmjet dialogut të respektueshëm dhe qëndrimit pozitiv ndaj argumenteve të bashkëbiseduesit.



Rekomandime për arsimtari

Çdo person ka cilësi të mira dhe karakteristika pozitive dhe aty është fuqia dhe aftësia e tij për të mësuar gjëra të reja, për të ndryshuar dhe për të marrë kontrollin e jetës së vet. Prandaj është me rëndësi që mësuesi t'i ndihmojë nxënësit të njohin pikat e forta dhe cilësitë e veta personale, sepse kjo çon në një vetëbesim më të madh dhe në rezultatet e tyre më të mira në shkollë.

Mësuesi duhet të pyesë veten se cilat janë cilësitë e tij personale të një mësuesi të mirë. Dhe të jetë i vetëdijshëm se mund të jetë një model i fuqishëm për identifikimin gjinor për studentët e tij. Nxënësit mësojnë nga marrëdhëniet, qëndrimet dhe veprimet e mësuesve të tyre, si dhe stili i mësimdhënies dhe vlerësimit.

Mësuesi duhet gjithashtu të jetë i vetëdijshëm për respektin/ shkeljen e të drejtave të nxënësve sa herë që ai/ ajo merr një qëndrim personal ndaj sjelljes së tyre gjatë vlerësimit ose gjykimit të tyre. Kompleksiteti i çështjeve të të drejtave të fëmijëve kërkon që të rriturit në arsim

të krijojnë rregulla dhe procedura shtesë për mbrojtjen e tyre dhe të sigurojnë që secili në bashkësinë e shkollës të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe me respekt.

Mësuesi duhet të jetë në gjendje të merret me mendime kontradiktore. Dhe ta menaxhojë diskutimin drejt ndërtimit të një pozicioni të përbashkët, në vend që të përdorë sarkazëm, ironi dhe sulme personale. Ai/ ajo duhet të demonstrojë se si diskutohet madje edhe në momentet e tensionuar, për shembull, duke iu drejtuar nxënësit që të përmbledhin (shkurtimisht) atë që kanë dëgjuar më parë nga bashkëbiseduesi para se të shpallin pozicionin e tyre. Për t'u siguruar se kanë kuptuar saktësisht. Në fund, të gjithë së bashku mund të përmbledhin dallimet dhe ngjashmëritë në mendimet dhe pozitat e tyre. Ai/ ajo duhet të njohë dhe të përdorë rregullat e fedbackut pozitiv dhe të flet në vetën e parë kur shpreh ndjenjat e tij/ saj, në vend që të theksojnë dobësitë e tjetrit/ tjetrës ose të kërkojnë justifikime në përgjegjësinë e palëve të treta.

Mësuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për shkallën e fuqisë që e posedon në raportet me nxënësit dhe të jetë i kujdesshëm për të mos e (keq) përdorë si një kërcënim, të mos bëjë kushtëzime ose manipulime me fuqinë, por ta shfrytëzojë për inkurajim dhe mbështetje, madje edhe kur nuk pajtohet me qëndrimet apo veprimet e nxënësve.

Por mbi të gjitha, prej mësuesit pritet të mos ketë paragjykimet personale, dilema dhe frustrime në lidhje me përkatësinë gjinore, seksuale etj. Ai/ ajo duhet të jetë i/e përgatitur ta mbrojë anën e fakteve, dhe kjo është ana e të drejtave të grave, burrave, por edhe të personave LGBT, për zhvillim të barabartë, mbrojtje dhe pjesëmarrje, dhe qasje të barabartë për të gjitha burimet e bashkësisë. Ai/ ajo duhet të demonstrojë qartë qëndrimin dhe sjelljen e tij/saj në klasë nëpërmjet sjelljeve, qëndrimeve dhe komenteve të respektueshme gjatë ligjëratave dhe bisedave me nxënësit mbi këto tema.

2.2

Ngritja e ndërgjegjësimit mbi dhunën dhe dhunën me bazë gjinore në shkolla

Ndërgjegjësimi se jetojmë në një mjedis të dhunshëm nuk është gjithmonë i pranishëm te njerëzit që jetojnë në bashkësitë ku kontrolli mbi tjetrin dhe keqpërdorimi i pushtetit janë sjellje pothuajse normative. Prandaj është e rëndësishme që me rinjtë të bisedohet për të gjitha format e dhunës. Është e rëndësishme që ata të njohin, emërojnë dhe informojnë për dhunën në kohën e duhur. Nxënësit gjithashtu duhet të mësojnë gjuhën (fjalorin) me të cilën do të raportojnë për përvojat e dhunës, nëse i kanë ato, të kuptohen dhe të marrin mbështetjen që u nevojitet. Ata gjithashtu duhet të informohen paraprakisht për të gjitha efektet negative të dhunës kundër jetës së të gjithë pjesëmarrësve.

TEMA 1:

**Dhuna, dhuna me bazë gjinore dhe
efektet negative mbi shëndetin**

PUNËTORI 1:

Dhuna dhe llojet e dhunës

Termi dhunë i referohet një game të gjerë aktesh dhe sjelljesh që shqetësojnë dhe shkaktojnë dëmtime. Përveç dhunës fizike, dhuna mund të jetë gjithashtu psikike, verbale dhe seksuale. Dhuna fizike përfshin një sulm dhe dëmtim të trupit, si dhe dëmtime (thyerje, demolime, djegie) të sendeve personale ose vjedhjen e gjërave të njerëzve të tjerë. Dhuna psikike përfshin kërcënime, abuzime, turpërim, siklet, gjë që i bën njerëzit të ndihen keq, të pasigurt dhe të pafuqishëm. Dhuna seksuale është kontakti i paligjshëm seksual (pa pëlqimin e palës tjetër) i cili përfshin: përdhunim, prekje në pjesët intime të trupit pa leje, komente seksuale, përhapja e gënjeshtreve dhe tregime të akteve intime, postimi i fotografive me përmbajtje seksuale. Dhuna verbale përfshin thirrje në formë të shkruar ose me gojë, emrat abuzivë, etiketimin, përhapjen e të pavërtetave/ thashethemeve.

Ushtrimi 1: Llojet e dhunës

Në disa fletë, nxënësit marrin një tabelë me katër fusha, me tituj: dhunë fizike, dhunë psikologjike, dhunë verbale dhe dhunë seksuale. Nën çdo titull, prej nxënësve kërkohet të shkruajnë shembuj, dhe pastaj të përpiqen të përshkruajnë secilën prej llojeve të dhunës. Disa lloje të dhunës shkojnë së bashku dhe janë të vështira për t'u dalluar dhe kufizuar, siç është dhuna psikologjike si pjesë përbërëse e të gjitha llojeve të tjera të dhunës.

Dhuna mund të ndodhë në të gjitha mjediset (familja, shkolla, mjedisi i punës, në hapësira të mbyllura ose të hapura). Ata zhvillohen në mënyrë të drejtpërdrejtë (ballë për ballë) ose përmes mediave sociale (dhunë elektronike), siç janë e-mail, SMS, statuse në Fejsbuk, Tuitër, Instagram, etj. Edhe fëmijët dhe të rriturit mund të gjenden në të dy rolet, rolin e viktimës dhe rolin e përdhunuesit.

Në skenën e dhunës shpesh janë kyçur edhe njerëz të tjerë - dëshmitarët si vëzhgues pasiv apo pjesëmarrës aktivë në rolin e mbështetësve/ ndjekësve që nxisin dhunën, bashkohen, apo zbaviten, ose ata në anën e viktimës, të cilët po tentojnë ta mbrojnë dhe ta parandalojnë eskalimin e dhunës.

Rezyme mbi dhunën, rolet dhe përgjegjësia

Format e dhunës mund të jenë të ndryshme dhe ndodhin në vende të ndryshme në shkollë

Ka më shumë se dy pozicione në aktin e dhunës: pozita e vëzhguesit – dëshmitarit dhe pozita e (bashkë)pjesëmarrësit në aktin e dhunës, në anën e dhunuesit ose në anën e viktimës.

Secila prej këtyre roleve është pjesë e përgjegjësisë për dhunën, por secila prej tyre mund të vuajë nga pasoja negative afatgjata prej përvojës së mbijetuar.



Çfarë duhet të dinë nxënësit për dhunën, rolet dhe përgjegjësinë?

Nxënësit duhet të dinë mbi format e dhunës, si dhe efektet që dhuna ka në të gjithë të pranishëm: të viktimës, dhunuesit, dëshmitarëve pasive dhe pjesëmarrës aktivë - mbështetësit / në të dyja anët/dhunuesit.

Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë ata që marrin pjesë në mënyrë pasive ose aktive në skenën e dhunës (kundërshtim, kërkim ndihmë, ose me mbështetje/brohoritje për dhunën), dhe pastaj të mendojnë nëse vetë ata janë gjetur dikur në një nga ato role.

Nxënësit duhet të dinë se secili prej këtyre roleve ka një pjesë të përgjegjësisë për dhunën dhe parandalimin/vazhdimin e saj.



Rekomandime dhe pritje nga arsimtarët

Për disa nxënës, dhuna është pjesë e jetës së tyre të përditshme dhe tema e dhunës është shumë e ndjeshme për ata. Prandaj është e rëndësishme që mësuesi të tregojë ndjeshmëri dhe diskrecion kur do ta hapë dhe do të diskutojë për temën. Disa nga fëmijët mund të gjenden në anën e kundërt, në anën e abuzuesit.

Mësimdhënësi duhet t'i përmbahet temës, pa emëruar askënd personalisht dhe të qëndrojë i fokusuar mbi sjelljet alternative jo të dhunshme në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive me nxënësit.

Ai/ajo duhet të përcjellë mesazhin e shmangies së klasës si një vend për tallje, bërtitje ose turp për nxënësit. Kjo gjithashtu do të thotë se arsimtari duhet t'i ndërpresë të gjitha tregimet e nxënësve në lidhje me bashkënxënësve të tyre, duke inkurajuar ata që dëshirojnë të raportojnë sjellje të dhunshme ta bëjnë raportimin ballë për ballë vetëm me mësuesin /personin përgjegjës.

Mësimdhënësi duhet të ofrojë kohën dhe vendin e duhur (kontekst të sigurt jashtë klasës) për biseda me secilën anë (viktimë, dëshmitar, përdhunues).

PUNËTORI 2:

Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ) dhe ndikim i normat gjinore mbi shëndetin

Dhuna në baza gjinore (DHBGJ) është nënkategori e dhunës ndërpersonale. Kjo përfshin forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe pritjet dhe stereotipat gjinorë. DHBGJ është çdo veprim/ akt që prodhon dëmtim fizik, mendor apo seksual ose vuajtje për personin (burrë, grua, person transgjisor apo person homoseksual, etj.), për shkak të mosplotësisimit të normave dhe pritjeve gjinore.

DHBGJ lidhet me jokonformitetin, dhe mbështetet në abuzimin e pushtetit në raportet. Abuzimi mund të jetë në kuptimin fizik, por mund të jetë edhe psikologjik dhe emocional. Për shembull, në rastin kur për dikë përhapen thashetheme, ose të tjerët binden të kthehen kundër interesave të dikujt, ose kur shkelen të drejtat e njeriut, ose dikush kontrollohet me kërcënime dhe frikë, vetëm për shkak se ky person nuk konfirmohet me rolin gjinor dhe pritjet e mjedisit.

Ushtrimi 1: Njohja e llojet e ndryshme të DHBGJ

Mësuesi u jep nxënësve disa skenarë të llojeve të ndryshme të DHBGJ: verbale (p.sh. fjalë vulgare ndaj një vajze që shkon në rrugë), fizike (shtyrje, goditje e një djalit i cili duket ose lëviz si një femër), psikologjike (përrjashtimi nga ekipi, të lojës, përhapja e thashethemeve për shkak të pamjes, lëvizjeve, veshjeve apo ngjyrës së zërit) dhe seksuale (prekje në pjesët intime, puthje pa leje).

Pastaj mësuesi fton nxënësit vetë (në grupe të vogla) të krijojnë skenarët e tyre dhe të diskutojnë për efektet e mundshme të këtyre përvojave mbi personin të cilit i ndodh kjo situatë. Gjithashtu, nxënësit duhet të japin sugjerime që do të parandalonin sjellje të tilla dhe do të zgjidhnin problemin.

DHBGJ gjithashtu lidhet me mënyrën se si shoqëritë dhe kulturat e ndryshme shohin dhe/ose kuptojnë rolet gjinore. Normat dhe rregullimi i tyre ndikojnë në organizimin e këtyre bashkësive, arsimimin e tyre, politikat dhe ligjet që me shkallë të ndryshme ndjeshmërie u përgjigjen çështjeve të të drejtave të gruas dhe burrit, dhe kështu edhe mbrojtjes së tyre nga DHBGJ. Në çdo bashkësi, DHBGJ dhe masat për parandalimin

dhe zvogëlimin e saj mbështeten në agjentë ndikues në shoqëri, siç janë kultura, feja dhe tradita që formojnë vlerat dhe standardizojnë sjelljen e anëtarëve të komunitetit.

Ushtrimi 3: Llojet e sjelljeve të dhunshme dhe reaksioneve emocionale



Mësimdhënësi kërkon prej nxënësve, jashtë dy figurave të dhëna, t'i shkruajnë llojet e sulmeve që ata i njohin ose i kanë ndodhur, ndërsa në brendësi të figurave, t'i shkruajnë të gjitha ndjenjat dhe emocionet që ata i shkaktojnë te të dyja gjinitë. E njëjta detyrë mund të jepet me një figurë të një personi transgjinitor.

Diskutimi duhet zhvilluar në drejtim të përcaktimit të dallimeve të mundshme ndërmjet dhunës mbi të dyja gjinitë, si dhe ku shfaqen më shpesh, cilat forma janë vërejtur në shkollën, nëse disa prej tyre pranojnë si "të justifikuara" dhe pse? Gjithashtu, a ka dhe cilat janë format e dhunës që edhe vetë vajzat i pranojnë dhe praktikojnë ndaj vajzave të tjera? Pse djemtë më shumë vuajnë nga dhuna fizike, në krahasim me vajzat mbi të cilat më shumë praktikohet dhuna seksuale dhe psikologjike?

Studimet e DHBGJ-së flasin për pasojat e rënda të përvojave të dhunës mbi shëndetin mendor dhe emocional të të rinjve (djem dhe vajza) që vuajnë nga depresioni, lodhje, ndjenja e pavlefshmërisë dhe pafuqisë dhe rritjen e rrezikut të varësisë nga alkooli dhe droga. Në situatë edhe më të vështirë

janë njerëzit¹⁹ transgjिनore ose homoseksualë, sepse ata gjithnjë e më pak duken ose sillen në përputhje me rolet dhe pritjet e përcaktuara gjinore.

Nëse dhuna vazhdon, pasojat e saj janë pasqyruar më tutje në mirëqenien e përgjithshme, funksionimin e përditshëm dhe rënia e imunitetit (9,13)

Ushtrimi 3: Analiza e dallimeve ndërgjinore dhe interpretimi i tyre

Nxënëseve u jepen lista me të dhëna nga hulumtimet, lokale dhe ndërkombëtare, mbi dallimet në shëndetin mendor, emocional dhe shoqëror, midis djemve dhe vajzave, si dhe në sjelljet e tyre që lidhen me shëndetin (shembuj në shtojcë). Pastaj përzgjidhet një grup zbulimesh, me dallime të mëdha ndërgjinore dhe pyetjet parashtrohen përpara klasës:

- Si mendoni pse ekzistojnë këto dallime në sjelljet apo gjendjen e të dy gjinive?

- Në cilën mënyrë normat gjinore mund të ndikojnë mbi këtë situatë?

Nxënësve pastaj u shpjegohet rëndësia e këtyre të dhënave, vlera e tyre krahasuese, për monitorim të situatës për një periudhë më të gjatë kohore dhe për përdorimin e tyre në politikat e qeverive për të reduktuar dallimet dhe për të përmirësuar kushtet për një shoqëri më të drejtë.

Nga faktet mund të shihet si normat dhe pritjet e rrepta dhe kufizuese gjinore të cilat prej djemve, për shembull, kërkojnë durim, forcë dhe guxim, dhe prej vajzave kërkojnë bindje, përlësi dhe ndjeshmëri, si ata mund të jenë në kundërshtim me nevojat, preferencat dhe të drejtat e tyre. Por, edhe si ndjekja e verbër e normave të përshkruara çon në zgjedhje të rrezikshme, shkatërrim të shëndetit dhe mundësi të reduktuara për jetë cilësore.

Për shembull, vajzat me sukses të shkëlqyeshëm në shkollë, shpesh janë çregjistruar nga shkollat në disa zona rurale në Maqedoni, për shkak se ka ardhur koha për t'u martuar, që është një shkelje e të drejtave të tyre për mundësitë dhe zhvillimin e të barabarta, me pasojat afatgjata për mirëqenien e tyre dhe shëndetin e gjeneratave të ardhshme.

¹⁹Couch, M., et al., Transnation: A report on the health and wellbeing of transgendered people in Australia and New Zealand. 2007, Australian Research Centre in Sex, Health and Society (ARCShS), La Trobe University: Melbourne.

Nga bisedat me prindërit e këtyre vajzave shumë shpesh mund të vërehet se vetë ata janë të vetëdijshëm për padrejtësinë shkaktuar, por nuk guxojnë të jenë të parët që do ta thyejnë "rregullin". Kjo do të thotë që guximi shpesh është i nevojshëm, përveç çdo gjëje tjetër, të përballojë presionin shoqëror dhe të braktiset norma e vjetër/ tradicionale gjinore.

Konventat ndërkombëtare si Konventa e OKB-së kundër diskriminimit dhe dhunës ndaj grave, d.m.th., Deklarata e Stambollit kundër dhunës në familje, të nënshkruar kohët e fundit edhe nga vendi ynë, janë presione nga ana e komunitetit ndërkombëtar mbi shoqëritë tradicionale, për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, mbeten pabarazi dhe dobësi në zgjidhjen e këtij problemi, kështu që prevalenca e dhunës me bazë gjinore është ende në nivel të lartë në mjediset tradicionale. Megjithëse ka dallime midis shtresave dhe grupeve të ndryshme të popullsisë, kështu që më të varfrit dhe të paarsimuarit janë më të prekshmit. Por, fakti është se dhuna me bazë gjinore vazhdon edhe në vendet më të zhvilluara, në të gjitha shtresat shoqërore të qytetarëve, duke përfshirë ato më të pasurat dhe/ ose me arsimim më të lartë. Natyrisht zgjidhja nuk është vetëm në statusin arsimor dhe mirëqenien, por edhe në vlera të tjera (të mësuara) që mungojnë, siç janë: respekti për diversitetin dhe për të drejtat e njeriut, d.m.th. aftësitë e komunikimit pozitive në ndërtimin e një komuniteti gjithëpërfshirës, në mënyrë të barabartë të mirë për të gjithë.

Ushtrimi 4: Përgatitje për prezantimin e gjetjeve

Nxënësit bëjnë zgjedhje dhe përgatisin një prezantim me gjetjet e marra, dhe pastaj përfundimet e tyre nga diskutimet, i prezantojnë me bashkëmoshatarët e tyre nga klasat e tjera ose të gjithë shkollën.

Ato mund t'i prezantojnë pikëpamjet e tyre edhe në mënyra kreative, në formën e veprave të artit - kënga, postere apo tregim/ strip, nëpërmjet të cilave do ta shprehin kuptimin dhe qëndrimin e tyre ndaj pabarazive gjinore dhe/ ose dhunës me bazë gjinore dhe pasojat e saj në shëndetin mendor, emocional dhe shoqëror të nxënësve. Nga materialet e mbledhura ata gjithashtu mund të përgatisin një fushatë me mesazhe që do të informojnë bashkësinë më të gjerë, lagjen dhe më gjerë, për pikëpamjet dhe përpjekjet e tyre.

Nxënësit mund të angazhohen në mënyrë aktive në reduktimin e dallimeve të ndërhyrjeve dhe në parandalimin e dhunës me bazë gjinore duke marrë pjesë në organe të posaçme të të rinjve dhe të rriturve të trajnuar, për mbrojtje nga DHBGJ në shkollë.

Ushtrimi 5: Ide për një qendër referimi për diskriminim gjinor në shkollën

Nga njohuritë e fituara, nxënësit janë të ftuar të bëjnë një draft për një qendër të referimit për diskriminim gjinor/ dhunë në shkollë, me një ekip të trajnuar të të rinjve për të mbështetur nxënësit e tjerë. Në këtë mënyrë, ata bëhen pjesëmarrës në një trajtim gjithëpërfshirës të problemit, me një plan dhe strategji të shkollës në trajtimin e problemit.

Rezime mbi dhunën me bazë gjinore dhe efektet e saj mbi shëndetin

Dhuna me bazë gjinore mund të ndodhë mbi këdo, por më së shumti vuajnë ata që refuzojnë haptazi të ndjekin rolet dhe pritjet gjinore të përshkruara.

DHBGJ-ja mund të kalojë pa u vënë re, madje edhe nëse pranohet, si një reagim i justifikueshëm ndaj mosbindjes ndaj normës, e cila zotëron fuqinë e një mekanizmi kontrolli të barabartë me ligjin.

DHBGJ-ja ka një kontroll të fortë dhe funksion korrektues, prandaj është vështirë që të dallohet si dhunë.

Dhuna me bazë gjinore ka ndikim negativ mbi shëndetin emocional, social dhe mendor të nxënësve, si dhe aftësitë e tyre të të mësuarit dhe suksesin në shkollë.

Njohja e efekteve të dhunës mbi shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve është hapi i parë drejt rezistencës ndaj këtij lloji të dhunës në shkolla.

Dhembshuri për viktimat dhe përvojat e tyre të dhimbshme është çelësi për reduktimin e sjelljen injoruese, toleruese dhe tallëse ndaj DHBGJ-së.

Hapat e para në kundërshtim të organizuar ndaj DHBGJ-së është njohja dhe emërtimi i të gjitha format e saj në shkollë, kualifikimin e tyre si sjellje të dëmshme dhe të papranueshme, që është përgjigje e vetme adekuate ndaj dhunës.

Zgjidhje të problemit të DHBGJ-së mund të gjejmë vetëm në kombinim të strategjive të planifikuara mirë dhe të lidhura brenda një sistemi për veprim parandalues.

Në mjediset tradicionale, nevojiten përpjekje të përbashkëta, që normat dhe pritjet e dëmshme gjinore të braktisen me anë të praktikave pozitive, udhëheqjes autoritare dhe modeleve për ndjekje, që me argumente të forta do ta mbrojnë anën për braktisje të miteve dhe stereotipave gjinorë.



Çfarë duhet të dinë nxënësit për natyrën dhe efektet e dhunës me bazë gjinore?

Dhuna me bazë gjinore në shumë raste relativizohet ose është e padukshme dhe shpesh është konsideruar si diçka të justifikuar ("çfarë ka kërkuar kjo vajzë të mbajë një fund aq të shkurtër ose të ngushtë, pse ka kaluar nga andej etj.")

Për shkak të qëndrimit të heshtjes, injorancës dhe mosndëshkimi, DHBGJ-ja perceptohet si një traumë të dyfishtë, së pari si një përvojë të përjetuar të dhunës dhe së dyti, për shkak të relativizimit të saj, si traumë për shkak të mosndëshkimit dhe mungesa e përkrahjes.

Pasojat e diskriminimit gjinor janë të menjëhershme dhe/ ose më të gjera në aspektin e jetës së viktimës dhe dëshmitarëve të dhunës. Këto janë: përqëndrimi i mirëqenies dhe funksionimit në përgjithësi, me ndjenjat të trishtimit, ankthit dhe ndryshimet e shpeshta në disponim, ndjenjat e pafuqisë. Gjithashtu ndikon mbi shëndetin fizik, rënien e imunitetit, dobësimin e vetëvlerësimit dhe/ ose kthimin në sjellje të rrezikshme.

Njohja e efekteve të DHBGJ-së mbi shëndetin dhe suksesin akademik të nxënësve, që mund të përfundojnë me largim nga shkolla, është shenja e parë e njohjes së saj dhe kundërshtimit ndaj dhunës në mjedisin shkollor.

Zgjidhja e DHBGJ-së është komplekse dhe mund të arrihet vetëm në kombinim me strategji të planifikuara mirë dhe me strategji sistematike të lidhura për parandalim dhe trajtimin. Nevojitet përpjekje nga e gjithë bashkësia, që normat e dëmshme gjinore të braktisen dhe të zëvendësohen me mbështetjen e udhëheqësve dhe modele pozitive, të cilët me guxim dhe dinjitetin do t'i kundërshtohen dhunës.

Shpesh nevojitet edhe guxim i madh individual, këmbëngulje dhe mbështetje të vazhdueshme në ndryshimin e normave dhe pritjeve gjinore, por çdo hap i vogël është i mirëpritur dhe mund të jetë i dobishëm. Prandaj, nuk është e nevojshme të presim shumë kohë për kushtet e veprimit.



Rekomandimet për arsimtarin

Arsimtari duhet t'ua rikujtojë nxënësve të drejtën e privatësisë, që do të thotë të japë shembuj që nuk përmbajnë emra personale, dhe të mos tregojë përvojat e të tjerëve në detaje, veçanërisht në praninë e nxënësve, dëshmitarëve të dhunës. Arsimtari duhet t'u referohet të dhënave përkatëse kërkimore (të cilat i ka studiuar mirë paraprakisht) me qëllim

që të argumentojë qëndrimet e tij para nxënësve dhe të jetë i hapur për të dëgjuar mendimin e nxënësve për çështjet për të cilat ai mund të ndajë edhe listat me të dhëna statistikore.


TEMA 2:

DHBGJ-ja në shkollën, qasja gjithëpërfshirëse

Dhuna me bazë gjinore në shkollat – qasja gjithëpërfshirëse në përballimin me dhunën

Përgjegjësia e të gjithë anëtarëve të bashkësisë është të promovojë shkollën si një mjedis të sigurt, miqësor dhe të këndshëm për mësim dhe zhvillim, për të gjithë fëmijët e saj. Një nga hapat e para në arritjen e këtij qëllimi është regjistrimi i pikave të mundshme të rrezikut të DHBGJ-së në shkollë, të cilat vetë nxënësit relativisht (dhe në mënyrë anonime) mund të eksplorojnë lehtë midis tyre. Informacioni se ku dhe kur DHBGJ-ja është më e zakonshme në shkollë, si ndikon mbi nxënësit dhe ku dhe si mund t'u jepet ndihma, mund të ndihmojë në reduktimin e rreziqeve dhe në përmirësimin e kushteve.

Ushtrimi 1: Harta e shkollës



Prej nxënësve kërkohet të bëjnë një hartë të shkollës së tyre, me të gjitha rrugët që çojnë në të dhe gjithë rrugët për t'u kthyer nga ajo në shtëpitë e tyre. Diskutimi duhet të drejtohet rreth vendeve të sigurta dhe të këndshme në shkollë dhe rreth saj, të cilat mund të shënohen me një ngjyrë dhe shenjë të caktuar (për llojin e kënaqësisë), në krahasim me ato ku fëmijët përjetojnë vështirësi dhe sulme, të shënuara me ngjyrë dhe shenjë tjetër (për llojin e dhunës). Këto analiza mund të ndihmojnë në zbulimin e sjelljeve të dhunshme duke identifikuar vendet kritike në shkollë.

Diskutimi shkon drejt ndërtimit të një shkolle të sigurt dhe të ndershme, e cila mund të fillojë me atmosferën në klasë dhe të miratojë rregulla pozitive të sjelljes në klasë. Pastaj diskutohet rreth mekanizmave shtesë për qëndrueshmërinë e atmosferës pozitive, ku secili ndihet i pranuar dhe i respektuar midis shokëve të klasës. Puna në studimin të pikave kritike të DHBGJ-së në shkollë, dhe rregullat e ndërtimit të një atmosfere të sigurt dhe pozitive në klasë duhet të jetë gjithëpërfshirëse që të gjithë nxënësit në klasë mund të marrin pjesë në të. Por, edhe mjaft e ndjeshme, duke kujdesur edhe për të rinjtë LGBT dhe grupet e tjera më të prekshme.

Ushtrimi 2: Rregullat për përmirësim të sigurisë dhe atmosferës në klasë

Учениците работат (во мали групи) на донесување правила за подобрување на сигурноста и атмосферата во класот / и училиштето.

Во разговорот учениците треба да се потсетат дека секој, независно од својот род, изглед, однесување и сл., а особено оние што НЕ се конформираат со родовите норми и очекувања, треба да имаат еднаков третман и да се чувствуваат еднакво безбедно, пријатно и вклучено, како и секој друг. Во оваа активност секој треба да биде вклучен, а не пречи групите да бидат и истородови.

Rregullat mund të ndahen në disa tema dhe fusha, për shembull, rregullat për një atmosferë të këndshme me ndërtimin të një mjedisi estetik dhe natyror që përshtatet me moshën, një mjedis të sigurt me rregulla pozitive për sjellje dhe komunikim, por edhe rregulla dhe procedura të gjithanshme për shkollën dhe bashkësinë.

Për shembull, procedurat për hyrjen në shkollë, për lëvizje nëpër korridoret (duke marrë parasysh moshën dhe fëmijëve të tjerë me nevoja të veçanta), standardet ekologjike të higjienës, ajri, drita, hapësirë dhe të ushqyerit; koha optimale për pushime me aktivitete fizike dhe të tjera; kënde kreative për relaksim dhe pushim; një sistem mësimi i nxënësve dhe nxënësve me detyra dhe përgjegjësi specifike; për grupet e organizuara të nxënësve që u ndihmojnë nxënësve më të rinj, ose patrollojnë për të parë se ku nevojitet ndihma etj.

Rezime – zbulim i vendeve kritike për DHBGJ dhe rregullat e veprimit

Dhuna mund të ndodhë në vende të ndryshme, në shkollë dhe afër shkollës, si dhe në rrugën nga shtëpia në shkollë.

Pikat kritike dhe njohja e modeleve të DHBGJ-së mund të ndihmojnë në zhvillimin e strategjive për parandalimin e dhunës dhe krijimin e vendeve të sigurta për nxënësit.

Rregullat për parandalimin e diskriminimit gjinor janë përgjegjësi e përbashkët e të gjithë anëtarëve të shkollës, të cilat duhet të fillojnë në klasë dhe me pjesëmarrje aktive të të gjithë nxënësve.

Rregullat duhet t'i marrin në konsideratë personat më të prekshëm në klasën, siç janë vajzat, të rinjtë homoseksualë ose transgjinorë, të cilët janë në rrezikun më të lartë të dhunës dhe diskriminimit.

Nevojiten rregulla të posaçme për vendet, në dhe përreth shkollës, ku janë regjistruar sulmet më të shpeshta (p.sh. patrulla të rregullta, ndriçim, kamera, etj.).



Çfarë duhet të dinë nxënësit për organizimin dhe përballimin me DHBGJ:

Rregullat duhet të bëhen transparente, dhe të bëhen të dukshme për të gjithë shkollën, duhet të përgatitet një strukturë të re ose të shfrytëzohet struktura hierarkike ekzistuese për raportim dhe veprim në shkollë nga ana e nxënësve, mësimdhënësve, prindërit, këshilli i prindërve, drejtori dhe këshilli i shkollës.

Me rregullat dhe procedurat është e nevojshme gjithashtu të miratohen masa për të mbrojtur rregullat e shkeljes dhe mospërfilljes.

Rregullat duhet të kenë kornizë kohore për testimin, me opsione për korrigjim, aty ku nuk i përmbushin pritjet e efikasitetit.



Rekomandime dhe pritje nga arsimtari

Gjatë formulimit të rregullave, mësuesi duhet të marrë parasysh ndarjen e përgjegjësisë dhe kush duhet dhe mund të jetë kompetent në shkollat, që rregullat për e miratuar të zbatohen në praktikë.

Arsimtari duhet të udhëheqë procesin e testimit dhe analizave të rregullave brenda afatit të parashikuar për kontrolle, ku ishin me dhe ku pa sukses, dhe cilat janë arsyet. Me mbështetjen e arsimtarit, nxënësit i perceptojnë pikat problematike dhe sugjerojnë ndryshime për të përmirësuar rregullat.

Në diskutimet me nxënësit, mësuesi duhet të përmbahen nga fyerjet dhe etiketimi i nxënësve që kanë kryer dhunë dhe të mos lejojnë ndonjë nga nxënësit të flasë drejtpërdrejtë për të tjerët në konotacion negativ. Ai / ajo duhet të bëjë një dallim të qartë midis sjelljes që është diskriminuese, dhe për këtë arsye edhe e papranueshme, dhe personaliteti i nxënësit, i cili edhe më tutje duhet trajtuar me respekt.

Mësuesi duhet të paralajmërojnë nxënësit që përdorin fjalë ofenduese siç janë: grua, pederast etj. për ta nënçmuar sjelljen ose pamjen e të tjetrit, dhe t'u shpjegojë nxënësve se ashtu bëjnë diskriminim të dyfishtë – nënçmojnë edhe vetë kuptimin e kësaj fjale, por diskriminojnë edhe personin për të cilin janë drejtuar këto fjalë ofenduese.

PUNËTORI 2:

Empatia, ndjeshmëria brenda klasës dhe falje

Empatia është aftësia për të imagjinuar dhe ndier atë që mendon dhe ndjen i tjetri. Ose, siç mund të themi, "Empatia është aftësia për të hyrë në këpucët e tjetrit/ tjetrës dhe për ta parë dhe ndier botën me sytë e shpirtin e tij/ saj".

Është e rëndësishme kur një person mund të ndiejë, për shembull, atë që përjetohet nga dikush që ndjen dhembje, humbje dhe traumë, ose gëzim dhe eksitim. Aftësia për të qenë empatik zhvillohet dhe mësohet. Kjo është një aftësi e ndjeshmërisë me tjetrën/ tjetrin, me vëmendje të plotë për atë që ai/ ajo po thotë, ose manifestohet me shprehjen e fytyrës, tonin e zërit, qëndrimin dhe lëvizjet e trupit.

Empatia na ndihmon të kuptojmë më mirë se çfarë po ndodh tek tjetrin/ën, madje edhe kur ndjenjat nuk shprehen në mënyrë të hapur, kur fshehin me mjeshtëri, maskohen apo shtypen. Ose kur qëllimisht i mbajnë vetëm për vete, si të drejtë privatësie. Në këto raste, ndjeshmëria ndihmon "të lexohet midis radhëve" dhe të arrihet deri në emocionet dhe ndjenjat reale, që në fakt janë agjente më fuqishëm të reagimeve, veprimeve dhe sjelljeve tona.

Ushtrimi 1: Loja e pantomimës

Arsimtari propozon të luajnë pantomimë në tema të lidhura me DHBGJ, ku nxënësit duhet të qëllojnë reagimet e ndryshme emocionale që vijnë si pasojë nga ndonjë rast dhune. Gjatë lojës, nxënësit e tjerë tentojnë që t'i dallojnë dhe t'i emërojnë modelet e gjendjeve të ndryshme emocionale.

Është shumë e dobishme për nxënësit të kuptojnë kompleksitetin dhe fuqinë e emocioneve dhe ndjenjave. Që ato veprojnë edhe kur të jenë të fshehura dhe të panjohura, që ato mund të jenë të dukshme ose të fshehura dhe se lehtësisht lidhen, transferohen ose transformohen në emocione të tjera. Për shembull, zemërimi dhe inati janë lehtësisht të dallueshëm, por shpesh herë janë shkaktuar edhe nga ndjenja e padrejtësisë ose pafuqisë; ndërkohë që xhelozia dhe dyshimi vijnë nga pasiguria e tyre dhe vetëvlerësimi i ulët, dhe mund të shfaqen gjithashtu si rezultat të frikës nga braktisja, e cila shpesh është e maskuar me ndjenjën e vlerës më të vogël.

Të gjitha llojet e emocioneve janë natyrore dhe njerëzore, por kontrolli i emocioneve negative është i domosdoshëm për të jetuar me dinjitet, siguri dhe cilësi. Emocionet e pakontrolluara negative si zemërimi, inati ose tërbimi janë shumë herë shkatërruese në jetën e njerëzve dhe të bashkësisë.

Ushtrimi 2: Tregime për DHBGJ me shprehje të emocioneve

Mësimdhënësi u sugjeron nxënësve (në grupe të vogla) të krijojnë tregime mbi temën e DHBGJ dhe të diskutojnë dy tipat e emocioneve, të fshehura dhe të hapura, që i ndjen protagonistin kryesor / viktimën e tregimit.

(Tregimet / skenarët mund të përgatiten edhe nga mësuesi.)

Në një fletë tjetër renditen emocione të fshehura si: trishtim, zemërim, shqetësim, frikë, turp, guxim, privim, dëshpërim, vetmia, pafuqinë, siklet, depresion etj.

Nxënësit mund të flasin për heroin kryesor dhe si ai përpiqet të fshehë disa nga emocionet e tij dhe sa ndryshe janë djemtë dhe vajzat në fshehjen e emocioneve?

A mund nxënësit t'i vërejnë dallimet? Çka mendojnë se atyre u lejohet të shprehin si emocionet dhe çfarë e kanë të ndaluar vajzat dhe djemtë nga kultura jonë?

Së fundi, të gjithë ne bëjmë gabime, por gabimet mund të korrigjohen, nëse ato vëren në kohë dhe pranohen. Kur mendojmë me ndjeshmëri, mund të vërejmë gabimet edhe më vonë, për shembull kur me reagimet apo fjalët tona kemi shkaktuar që dikush të ndihet i turpëruar ose kemi shkelur mbi dinjitetin e tij. Në rrethana të tilla, guximi nevojitet për të njohur gabimin dhe për të kërkuar falje.

Por falja nuk është gjithmonë e lehtë dhe shpesh është e nevojshme për nxënësit që të inkurajohen dhe ta bëjnë këtë hap, kështu që së pari do të mësojnë se si dhe çfarë të bëjnë kur kërkojnë falje.

Tabela 10: Gjashtë hapa për falje të suksesshme dhe të lehtë

Plan për nxënësit të cilët pranojnë se kanë bërë gabim, që të kërkojnë falje më lehtësisht.

Nxënësi që ka bërë gabimin duhet:

1. Të tregojë se çfarë ka bërë ose çfarë ka treguar për dikë tjetër, për që mendon se nuk është në rregull.
2. Ta përshkruajë shkeljen, sulmin ose efektet e tjera që janë shkaktuar mbi personin e lënduar.
3. Të tregojë për qëllimin e vet, çfarë ka dëshiruar të arrijë ose demonstrojë.
4. Të tregojë se çfarë ka ndërmend të bëjë në të ardhmen në lidhje me këtë çështje, për shembull, a ka ndonjë ide se si ta korrigjon situatën, të paguajë dëmet, ose të premtojë se nuk do të përsëritet ose të ofrojë diçka në këmbim etj.
5. Të kërkojë falje.
6. Të pranojë reagimin që vjen nga ana tjetër, duke lënë kohë të mjaftueshme për të menduar kur dhe nëse do ta pranojë faljen.

Ushtrimi 3: Falje

Nxënësit praktikojnë se si kërkohen falje në skenarë të gatshëm, duke ndjekur hapat e mësipërm, me teknikën e roleve të ndryshme. Diskutimi bëhet rreth guximit për të pranuar gabimin e tyre, dhe dallimet kur ka/ nuk ka falje, dhe çfarë efekt ka kjo mbi hapat e mëtejshme, pra mbi reduktimit të efekteve të dëmshme të shkeljes.

Rezyme mbi empatinë, emocionet dhe faljen

Empatia është aftësia për të imagjinuar dhe ndier atë që mendon dhe ndjen i tjetri në atë moment. Aftësia zhvillohet dhe mësohet duke praktikuar aftësitë e shikimit, dëgjimit, imagjinatës, kontrollit dhe kujdesit ndaj tjetrit.

Aftësitë e vëzhgimit, të dëgjuarit dhe kujdesin për njëri-tjetrin janë më të rëndësishme për identifikimin e njerëzve që kanë mbijetuar ndonjë traumë dhe nuk janë ende gati për të zbuluar dhimbjen e tyre përpara të tjerëve.

Ato janë të rëndësishme për zhvillimin e ndjeshmërisë me të tjerët, duke zhvilluar një qëndrim më njerëzore, i cili redukton aftësinë për të vepruar me dhunë, ose justifikuar dhunën.

Emocionet janë të dukshme nga gjuha e trupit, por ka edhe të tilla për të cilat njerëzit nuk flasin, i maskojnë ose i fshehin. Dhe kur emocionet e padukshme dhe të errët janë rezervuare të fuqishme të energjisë, të cilat ndikojnë në veprimet dhe sjelljet tona.

Njohja, emërtimi, kontrollimi dhe përcjellja e emocioneve negative mund të ndihmojnë shumë në reduktimin e efekteve të tyre shkatërruese në jetën e njeriut dhe të komunitetit.

Falja mund të lehtësojë dhimbjen dhe të dëshmojë se jemi të ndjeshëm dhe vetëkritik, kur vëmë re dhe njohim lëndimin që kemi shkaktuar me pakujdesinë tonë.



Çfarë duhet të dinë nxënësit për empatinë, emocionet dhe faljen?

Empatia është aftësia për të paramenduar dhe ndier se si dikush ndihet në një moment të caktuar. Me aftësitë për vëmendje dhe të dëgjuarit aktiv, si dhe për kujdes për të tjerët, gjithkush mund ta përmirësojë aftësinë për ndjeshmëri.

Aftësitë empatike janë shumë të rëndësishme, sepse viktimat e DHBGJ kanë më shumë gjasa të heshtin për atë që u ka ndodhi. Empatia mund të na ndihmojë të zbulojmë shpejt traumën dhe vuajtjet e tyre, t'i kuptojmë dhe t'u ndihmojmë më mirë.

Nxënësit duhet të njohin natyrën dhe ndikimin e emocioneve të fshehura, të maskuara dhe/ ose të shtypura. Disa nga këto emocione njihen lehtësisht ose "lëshohen" përmes gjuhës joverbale të trupit, por shumë prej tyre janë të shtypur thellë, mbeten të ndikuara dhe të menaxhuara nga zgjedhjet dhe vendimet tona.

Në qoftë se ne e dimë se si të identifikohemi me viktimat e DHBGJ-së dhe e dimë se si të jemi empatik me përvojat e tyre të vështira, ka më pak rrezik që ne do të gjendemi në anën e kryerësit, apo mbështetësit të një sjelljeje të dhunshme.

Gjithkush bën gabime, por ka vend për falje. Është e nevojshme të shihet dhe të pranohet gabimi dhe të dihet se si të kërkohet falje.



Rekomandime për arsimtarin

Është me rëndësi që arsimtari të jetë i vetëdijshëm se për shkak të normave gjinore, nganjëherë është shumë e vështirë që të dallohet dhe pranohet DHBGJ (shembuj nga fushata "Tani tregoj" në Maqedoni dhe "Edhe mua gjithashtu" në Amerikë), bile edhe midis anëtarëve të të njëjtit seksi.

Arsimtari duhet ta njohë mekanizmin e DHBGJ që më lehtësisht ta dallojë:

Kur dhuna relativizohet dhe përgjegjësia shmanget, me çdo presion për pranim të fajit, përgjegjësia transferohet mbi viktimën. Ideja është që vëmendja të fokusohet mbi viktimën, mbi pamjen dhe sjelljen e viktimës, me qëllim që të problematizohet për të shkaktuar turp dhe siklet, dhe pastaj, madje edhe më lehtësisht te viktimat kërkohen arsytet për rastin e dhunës. Në rastet kur viktimat nuk ka mbështetje të jashtme, viktimat nuk ka çfarë tjetër përveç se të tërhiqet dhe të heshtë për ta mbrojtur veten

nga dhuna mëtejshme. Me të, mbyllet rrethi i dhunës, me një traumë të pazgjidhur, dhe tani viktima (grua, në këtë rast) ka vetëbesim edhe më të ulët, me që në rastin tjetër dhune do të jetë një target më të lehtë. Mekanizmi i njëjtë mund të zbatohet edhe për llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore.

Arsimtari mund të luajë rol të rëndësishme në ndalimin e DHBGJ-së, gjithmonë kur do të marrë vesh ose do të jetë dëshmitar i dhunës. Ai/ ajo në asnjë mënyrë nuk duhet ta relativizojë ose të injorojë dhunën me bazë gjinore, sepse për nxënësit kjo do të thotë viktimizim të trefishtë: mohim i problemit, mosnjohja e lëndimit, dhe mungesa e përkrahjes. Për të gjithë ata që njëherë e kanë përjetuar dhunën dhe që kanë pasur guximin ta raportojnë dhe të luftojnë kundër dhunës, mungesa e mbështetjes do të thotë lëndim të madh, ndonjëherë madje edhe lëndim më i madh sesa vetë akti i dhunës.

2.3

Shkathtësi komunikimi për marrëdhënie pozitive dhe të respektueshëm me të tjetrin/tjetrën

Marrëdhëniet gjinore pozitive janë pjesë e strategjisë për parandalimin e dhunës me bazë gjinore. Me aftësitë e komunikimit pozitiv dhe dinjitoz të ndërgjinore, nxënësit fitojnë një avantazh të madh në kuptimin dhe pranimin e diversitetit.

TEMA 1:

Shkathësi për komunikim pozitiv në parandalimin dhe trajtimin e DHBGJ-së

PUNËTORI 1.

Çfarë bëjnë miqtë e mirë?

Për të rinjtë, miqësia është shumë e rëndësishme sepse ofron një ndjenjë të përkatësisë dhe të pranimit, dhe ua ofron ndjenjën se janë vërejtur, të rëndësishëm dhe të çmuar. Por ndërtimi i marrëdhënieve miqësore nuk është gjithmonë i lehtë, veçanërisht kur ekziston frika e braktisjes dhe/ ose vetmisë. Nevoja për të kënaqur të tjerët edhe kur kjo nuk u pëlqen, thjesht sepse kanë frikë për të mos humbur miqësinë, i ekspozon nxënësit me rrezikun e manipulimit dhe dhunës. Të rinjtë janë të pasigurt dhe shpesh shqetësohen nëse dikush i do apo jo.

Prandaj është e rëndësishme që nxënësit të dinë se si të njohin se çka është atë që e vlerësojnë në miqtë e tyre, dhe çfarë duan/ presin prej miqtë e tyre. Dhe duhet të kanë kujdes që t'u mos nënshtrohen me çdo kusht. Dallimi midis marrëdhënieve të bazuar në respektin e ndërsjellë dhe marrëdhënie manipulative dhe të dhunshme, është mësimi i parë për nxënësit.

Ushtrimi 1: Karakteristikat e pranueshme dhe jopranueshme te miqtë?

Prej nxënësve kërkohet të rendisin cilësitë e miqve me të cilët shoqërohen dhe t'i shkruajnë në dy kolona: ato që u pëlqejnë dhe ato që nuk u pëlqejnë, pa emëruar emra personale të shokëve. Mësuesi pastaj mund të shtojë një listë prej 50 shprehjeve të mirësisë (në shtojcë) dhe t'i përfshijë ata në përzgjedhjen e atyre që mendojnë se do të ndihmonin më mirë nxënësin të ndihej i pranuar dhe i pëlqyeshëm midis bashkëmoshatarëve.

Ushtrimi 2: Varianti shtesë i ushtrimit 1

Është mirë kur shoku yt

Është i besueshëm/ e bësueshme

Të gëzon

Të ndihmon me detyrën shtëpie

Ndan gjëra me ty

Të fton që të shoqëroheni

Nuk është mirë kur shoku yt

Përhap thashetheme për ty

Është i pandershëm

Të urdhëron

Është xheloz

Nuk ka kohë për ty

Tallet me ty

Marrëdhënie me respekt midis vajzave dhe djemve









Lidhjet ndërgjinore kanë një cilësi të veçantë, varësisht nga mosha dhe konteksti në të cilin po zhvillohen (familja, shkolla, vendi i punës). Mësuesi mund t'i kërkojë nxënësve t'i japin disa nga cilësitë që ata kanë diskutuar, por tani midis djemve dhe vajzave (gra/ burra) - bashkëmoshatarët, bashkëshortët, bashkëpunëtorët, vëllezërit dhe motrat.

Ushtrimi 3: Cilësitë e shokëve të ngushtë

Arsimtari kërkon prej nxënësve ta përdorin përsëri listën me cilësi të dëshiruara të miqve (nga aktiviteti i mëparshëm) dhe pranë secilës cilësi të vënë shenjë të ndryshme – për vëllai/ motër *; për partner/e <3 ; dhe për bashkëpunëtor/ koleg #

Por vetëm për persona nga seksit të kundërt

Është mirë kur miku/mikja tuaj vëllai/motra tuaj partneri/e kolegu/e:

- Është i/e besueshëm/me 
- Të gëzon 
- Të ndihmon me detyrën shtëpie 
- Del me ty 
- I ndan gjërat me ty 
- Të kyç në aktivitetet 
- Kupton kur e ke të vështirë 
- Respekton mendimin tuaj 

Nxënësit nxiten të plotësojnë listën me cilësi të tjera dhe të shohin se nuk ka dallime të rëndësishme në karakteristikat e dëshiruara, në marrëdhëniet pozitive ndërgjinore.

Rezyme mbi marrëdhëniet pozitive ndërgjinore

Cilësia e një relacioni mbështetet dhe ndërtohet mbi komunikimin e hapur, të sjellshëm dhe të respektueshëm me tjetrin, në çdo mjedis.

Cilësitë që presim nga miqtë, në lidhje me barazinë dhe respektin, i dallojmë edhe në marrëdhëniet afatgjata dhe të suksesshme ndërgjinore, në familje, në shkollë dhe në vendin e punës.

PUNËTORI 2.

Si të tregojmë JO – qartësisht, në mënyrë të sjellshme dhe me respekt

Njerëzit kanë nevojë të fitojnë aftësi për të komunikuar nevojat dhe të drejtat e tyre me të tjerët (prindërit, miqtë, eprorët, të panjohurat), pa qenë të dhunshëm, pa u mbrojtur ose tërhequr. Ata mund të mësojnë se si të sigurohen se të drejtat e tyre respektohen pavarësisht se e cila është pozita që e zënë për momentin dhe sa e fuqishme është ajo.

Me fjalë të tjera, kjo është aftësia për të thënë JO kurdo që gjërat nuk janë të mira për njeriun, kur janë ofenduese ose të rrezikshme

Tabela 11: Stilet e komunikimit në situatat e ndjeshme

Agresiv – personi i shpreh ndjenjat, qëndrimet dhe mendimet e tij në një mënyrë kërcënuese, duke e nënçmuar bashkëbiseduesin. Ai insiston që të drejtat e tij të respektohen dhe plotësohen, por nuk është i interesuar për të drejtat e personit tjetër.

Mesazhi është: Kjo është që dua unë, nuk më intereson se çfarë do ti.

Ky stil përdor fuqinë e vet për të imponuar veten në anën tjetër.

Me vetëbesim – i qartë, i sjellshëm dhe i respektueshëm – personi komunikon në mënyrë të hapur për të drejtat, mendimet dhe qëndrimet e tij, pa fyer, poshtëruar apo mohuar mendimin dhe të drejtën e bashkëbiseduesit. Në këtë marrëdhënie, PO ose JO është thënë me dashamirësi dhe respekt ndaj tjetrit, por pa sakrifikuar të mirën e vet dhe pa faj për zgjedhjen e bërë.

Mesazhi është: Unë respektoj veten time, por të respektoj ty gjithashtu.

Nështruar – personi nuk shpreh ndjenjat, nevojat, qëndrimet dhe preferencat e tij, ose i shpreh në një mënyrë kaq indirekte që bashkëbiseduesi nuk i njeh/ kupton mesazhet. Këta njerëz bien dakord të bëjnë gjëra, edhe kur ato janë të dëmshme pas tyre, vetëm për të mos thënë JO dhe shpesh ndihen fajtorë kur duhet të refuzojnë dikë.

Mesazhi: ajo që po më pyetni është më e vlefshme se sa kush jam dhe si ndihem. Nuk kam rëndësi këtu, nuk duhet të shqetësoheni për mua.

Është edhe më efektive nëse nxënësit i luajnë skenarët me role ku mund të shihni gjuhën e trupit, shprehjen e fytyrës dhe verbalizimin. Nxënësit mund të krijojnë skenarët e tyre me shembuj të komunikimit të ndjeshëm.

Ushtrimi 1: Skenarët me tri stile të përgjigjes ndaj dhunës

Pasi ua prezantoni tri stilet e sjelljes, mësuesi ofron disa skenarë nëpërmjet të cilave nxënësit duhet të ilustrojnë tri llojet e përgjigjeve.

Skenari 1:

Miqtë mbledhen për të luajtur futboll, njëri pyet: "A ta ftojme Metin?" Të tjerët qeshin: "...ai është pederast, nuk luan futboll." Metin e dëgjon komentin, dhe reagon në tri mënyra.

- Agresivisht - Ti je pederast, e jo unë ... Unë jam Ronaldo për ty ...
- Me vetëbesim - Unë jam i mirë në futboll dhe mund të fitoni nëse luaj. Mbani këtë mendim për veten tuaj.
- Vartëse - Metin nuk thotë asgjë, bën sikur nuk e ka dëgjuar bisedën.

Skenari 2:

Tre djemtë qëndrojnë në fund të korridorin e shkollës, duke kaluar një nxënëse (16 vjeçare). Kjo tentohet të jetë sa më e padukshme që të jetë e mundur, por nuk mund t'i shmangë komentet me fjalë abuzive për trupin dhe pamjen e saj. Ajo reagon:

- Agresive - Marsh budalla, shikoni veten në pasqyrë.
- Me vetëbesim - Djemtë, kjo nuk është mënyra më e mirë për t'u paraqitur përpara një vajze. Dini ju edhe më mirë.
- Nënshtruar - Vajza po largohet shpejt, dhe pastaj fillon të qajë.

"Flas unë" në shprehjen e emocioneve, në situata të tensionuara

Marrëdhëniet me njerëzit janë plot me sfida dhe është e dobishme të dinë se si t'i shprehim emocionet tona në situata të tensionuara, sidomos në afërsi dhe/ose marrëdhënie intime me të tjerët kur ne jemi të shqetësuar, të frikësuar, ofenduar apo pasigurt prej asaj që na pret.

Për shembull, kur jemi të shqetësuar, është mirë që t'i tregojmë të tjerëve se si ndihemi dhe çfarë na shqetëson, por duke mbajtur nën kontroll mënyrën e komunikimit.

Nëpërmjet teknikës "flas unë", d.m.th. drejtimi në personin e parë njëjës, është më e lehtë që të shprehim se si sjellja ose veprimet e njerëzve të tjerë bëjnë të ndihemi. Përdorimi i teknikës "flas unë" në komunikimin konfliktuese mundëson

që të flasim për vetveten pa akuza të ndërsjella, sulme dhe arsyetime, me që komunikimi vazhdon me perspektiva shumë më të mira për të zgjidhur problemin. "Flas unë" mund të përdoret gjithashtu për të ofruar zgjidhje.

Tabela 12: Llojet e "flas unë"

Shembuj për "flas unë"

- - Kur tallesh me mua se jam e shëndoshë, ndihem e paretshme dhe e trishtueshme.
- - Kur organizoheni për të shkuar diku pa më ftuar, ndihem i harruar dhe i refuzuar.
- - Kur më ndërpret në mes të fjalës, ndihem sikur mendimi im nuk ka rëndësi ose nuk të intereson çfarë mendoj.

Shembuj me "flas unë" me zgjidhje të propozuar:

- - Kur tallesh me mua se jam e shëndoshë, ndihem e paretshme dhe e trishtueshme dhe të lutem mos e bëj më shumë para miqve të mi.
- - Kur organizoheni për të shkuar diku pa më ftuar, ndihem i harruar dhe i refuzuar. Në të ardhmen, më thoni se nuk më keni planifikuar ose që keni plane të tjera, në vend që të marr vesh vetë unë, nuk do të zemërohem.
- - Kur më ndërpret në mes të fjalës, ndihem sikur mendimi im nuk ka rëndësi ose nuk të intereson çfarë mendoj. Së pari dëgjo atë që kam të të them, pastaj trego mendimin tënd.

Ushtrimi 2

Mësuesi e prezanton (para nxënësve) modelin e "flas unë" (në vazhdim) dhe i fton ata të praktikojnë në skenarët tashmë të njohur. Mësuesi/nxënësit mund të marrin shembuj të letërsisë me protagonistë që ndihen të trishtuar, depresionuar, të pakënaqur dhe të përpiqen me "flas unë" t'i shprehin ndjenjat e tyre në dialog me personazhe të tjerë.

Tabela 13: Modeli i "flas unë" me zgjidhje të ofruar

- Ndihem _____ (trego se si ndihesh).
- Për shkak të _____ (trego sjellja ose ngjarja që ishte shkak)
- Prandaj _____ (trego pritjen ose kërkesën për ndryshim)

Ndihem keq kur i huazon gjërat e mia pa më pyetur, dhe kur nuk janë aty dhe mua më nevojiten, prandaj të lutem të më pyesësh para që të marrësh.

Rezyme mbi komunikimin ndërnjerëzor në situata konfliktuese

Sjellja e qartë, e sjellshme dhe e respektueshme na ndihmon që t'i mbrojmë të drejtat tona pa u shkelur ose sfiduar të drejtat e tjetrit.

Aftësia për të thënë JO, kur gjërat nuk janë të mira ose janë të dëmshme për dikë, në mënyrë të respektueshme për mendimin dhe qëndrimin e tjetrit, forcon të rinjtë dhe u mundëson që të merren me sukses me sjelljen e dhunshme dhe konfliktuale.

Teknika "flas unë" është një mënyrë për të shprehur emocionet e veta në marrëdhënie komplekse dhe të tensionuara, me vetëbesim, që përfshin kujdesin e mirë për veten, pa akuzime dhe transferimin e përgjegjësisë tek tjetri.



Çfarë duhet të dinë nxënësit për stilet e komunikimit në situatat e dhunshme?

Nxënësit duhet të jenë të kujdesshëm që të mos pranojnë atë që nuk u pëlqen te shokët dhe bashkëmoshatarët e tyre dhe të mos u nënshtrohen me çdo kusht. Ata duhet të mësojnë të bëjnë dallimin midis marrëdhënieve të bazuara në respektin e ndërsjellë dhe marrëdhëniet manipuluese dhe të dhunshme, pa frikën e humbjes së miqësisë nëse kundërshtojnë dhe thonë JO.

Cilësitë që presim nga të tjerët në marrëdhëniet ndërgjinore janë shumë të ngjashme me ato që presim nga miqtë. Shumë nga cilësitë që sigurojnë barazinë dhe respektin njihen si më të dëshiruara në marrëdhëniet e ngushta.

Për të mësuar t'u thonë JO presioneve, pritjeve dhe lëndimeve, në mënyrë të sigurt, nxënësit duhet të njihen me tre stilet e reagimit (agresiv, asertiv dhe i nënshtruar) dhe të bëjnë zgjedhje të drejtë për të mbrojtur të drejtat e tyre për mendim dhe qëndrim.

Sjellja me vetëbesim (në mënyrë të qartë, të hapur dhe me respekt për tjetrin) lejon të shprehin ndjenjat nevojat, të drejtat dhe opinionet e tyre në mënyrë legjitime, pa kërcënime dhe shkeljet e bashkëbiseduesit .

Nxënësit duhet të mësojnë të aplikojnë teknikën "unë flas" në situata kontradiktore dhe të ndjeshme, me dinjitet dhe kontroll mbi emocionet e tyre. Teknika "unë flas" ose drejtimi në vetën e parë njëjës, mban komunikimin pa pasur nevojë të zhvendoset terrenin e akuzave, sulmeve dhe arsytetimeve të ndërsjella, me më shumë shanse për zgjidhje të problemit.



Rekomandime dhe pritje nga arsimtari

Mësuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për mënyrat e ndryshme të komunikimit dhe shprehjes së emocioneve, dhe ai vetë t'i praktikojë ato, dhe jashtë shkollës.

Është e dëshirueshme që mësuesi personalisht t'i ketë ndërë aspektet pozitive të sjelljes me vetëbesim dhe të teknikës "unë flas" dhe potencialin e tyre për një mirëkuptim më të mirë ndërmjet njerëzve, veçanërisht ndërmjet gjinive të ndryshme, si dhe për forcimin e individit, rritjen e vetëbesimit në komunikimin e ndërsjellë dhe mbrojtjen e lirive.

TEMA 2:

Dëshmitarët e dhunës dhe aftësi për reagim

PUNËTORI 1.

Efektet e dhunës mbi dëshmitarin/ dëshmitarët

Dëshmitar është çdokush që ka qenë prezent ose ka dëgjuar për dhunën prej të tjerëve.

Forcimi i dëshmitarëve për t'iu përgjigjur dhunës ka një efekt më të madh në parandalimin e dhunës sesa nëse fokusohemi vetëm mbi kryerësin dhe viktimën, tregojnë hulumtimet e ngacmimit në shkolla.

Ushtrimi 1: Nxënësit në role të dëshmitarëve

Mësuesi i fton nxënësit, në skenarë të caktuar të dhunës me bazë gjinore, të mendojnë për rolin e dëshmitarëve, si ndihen dhe çfarë mendojnë në atë moment.

Shembuj të ndjenjave dhe mendimeve:

Kam frikë; a duhet të ndërhyj; a të kërkoj ndihmë; mos e keqësoj situatën; a të bëj se nuk më intereson; shkolla është e pasigurt; si do ta përballohesha unë në vendin e tij etj.

Pyetje të mundshme për diskutim:

- A do të ndryshonte diçka nëse viktimia apo abuzuesi do të ishin një seksi tjetër, ose një tjetër moshë (më të rinj ose më të moshuar), ose më të trashë/ më të dobët?
- Çfarë do të ishin reagimet dhe veprimet e dëshmitarit në skenarin e dhënë?

Ndërtimi i strategjive për mbështetje

Është e rëndësishme të dihet se dëshmitari mund të ndikojë në ndalimin e dhunës dhe reduktimin e pasojave të tij, por gjithashtu që të kontribuojë në pranimin ose inkurajimin e tij, nëse ai bëhet pjesë e audiencës mbështetëse dhe brohoritëse ose bashkohet me grupin e dhunshëm.

Ushtrimi 2: Çfarë mund të bëjë dëshmitari në lidhje me rastin dhune?

Në skenarin e përgatitur të DHBGJ-së, prej nxënësve kërkohet të rendisin reagimet dhe sjelljet e një dëshmitari të imagjinuar të dhunës. Pastaj, nga reagimet e renditura, ndani reagimet negative (të cilat njihen si përdorim negativ të fuqisë së dëshmitarit: tallje, brohoritje etj.) dhe ato pozitive (përpjekjet për ndihmë që dhuna të ndërpritet). Pastaj, nxënësit duhet t'i fshijnë ato negative dhe të mbeten vetëm pozitivet, si:

- Kërko prej abuzuesit që të ndërpresë
- Vazhdo përgjatë rrugës, por shpejt pas alarmo një person përgjegjës
- Kërkoje viktimën që ta pyesësh se si ndihet
- Thirrni oficerin e detyrës, ose sigurinë e shkollës
- Tregoju miqve
- e tjerë

Nxënësve u shpjegohet se dëshmitari i dhunës nuk e ka të lehtë dhe të thjeshtë të ndërmarrë veprime sepse ka rreziqe reale. Strategjitë pozitive dhe efektive janë gjithmonë të lidhura me sigurinë personale. Sipas mundësive për ndihmë, ato ndahen në strategji të menjëhershme (gjatë dhunës) dhe strategji të shtyra (pak kohë më vonë).

Ushtrimi 3: Praktikum i vlerësimit të mirë për përfshirje

Nxënësit (në çifte) marrin skenarë të gatshme në të cilat ata vendosin se çka është më mirë – të reagohet menjëherë ose në mënyrë të shtyrë (pak më vonë), duke marrë parasysh dy gjëra – fuqia e dhunuesit dhe siguria personale.

Nxënësit duhet të diskutojnë pozicionin dhe rolin e dëshmitarit në skenarët specifikë dhe të bëhen të vetëdijshëm se vetë ata duhet të vlerësojnë se çfarë është më mirë që të bëhet dhe cila është zgjidhja më e sigurt për ta dhe për viktimën. Dëshmitari që vepron duhet ketë paraprakisht njohuri mbi rreziqet, si dhe të vlerësojë se çfarë është më mirë të bëhet në situatën e caktuar - si të reagohet menjëherë dhe çfarë duhet bërë më vonë, në mënyrë që të zvogëlohen rreziqet. Marrja e masave kundër dhunës kërkon forcë, vetëbesim, guxim dhe përkrahje.

Nxënësit gjithashtu duhet të bëhen të vetëdijshëm për veprimet e tyre të përkrahësve dhe inkurajuesve të dhunës kur qeshin ose inkurajojnë shokët e tyre në ngacmime për zbatimje.

Rezyme mbi rolet e dëshmitarit mbi dhunën dhe rreziqet

Përveç viktimës, dëshmitari i dhunës mban lëndime dhe mund të zhvillojë ndjenja të forta frike dhe shqetësuese për vetveten dhe për sigurinë e të tjerëve.

Në disa rrethana, dëshmitari mund të mendojë se sjellja e dhunshme është një mënyrë e zakonshme e sjelljes dhe se është e pranueshme që i tjetri/ e tjetra të trajtohet në atë mënyrë.

Efektet e aktit të dhunës mund të jenë ndjenja e pafuqisë dhe zgjedhja për të qëndruar pasiv është një shprehje e frikës se dikush mund të bëhet lehtë objektivi i të njëjtës dhune dhe autorëve të saj.

Është e rëndësishme që të investohet në fuqizimin e dëshmitarëve për t'iu përgjigjur dhunës në mënyrë të duhur dhe efektive.

Forcimi i dëshmitarëve, kur dhe si reagojnë ata, ka një efekt më të madh në parandalimin e dhunës sesa vetëm të fokusohemi tek abuzuesi ose viktimja.

Dua të ndihmoj – si, kur dhe ku?

Një pjesë e strategjive të ndihmës duhet të përfshijnë gjithashtu vendimin se ku duhet të raportohet dhuna. Mund të jetë personi përgjegjës (nëse ka), i rritur (i besuar) në shkollë, ose siguria/ roja (nëse janë trajnuar për DHBGJ). Në disa shkolla ekziston edhe një grup i veçantë i nxënësve (lloji i mbështetjes institucionale të bashkëmoshatarëve) dhe mësuesit, te të cilët mund të raportohet dhuna. Është më mirë nëse shkolla ka një qendër referimi për raportimin e dhunës në shkollë. Të gjitha këto organe dhe pikat mbështetëse, me protokolle të zhvilluara të veprimit, duhet të jenë pjesë e strategjive të shkollës për të ndihmuar viktimave/ dëshmitarëve të dhunës. Kështu, edhe dëshmitari i dhunës, si dhe bashkësia janë më të mbrojtur.

Aftësitë për reagim efektiv dhe në kohë lidhen jo vetëm me nevojën për ndihmë, por edhe me vlerësimin e kushteve (çfarë, si dhe ku) në dhënien e ndihmës.

Ushtrimi 1 : Vlerësim i momentit/ kohës dhe formave të intervenimit

Prej nxënësve kërkohet të punojnë disa skenarë, në vendimet dhe vlerësimet e tyre për çështjet e mëposhtme:

- siguria e viktimës / vetë – Në rastin që një nxënës – dëshmitar i një akti dhune, duhet të bëjë diçka urgjente, si do ta vlerësonte sigurinë e tij/ saj dhe çfarë do të bënte?
- mbështetjen midis bashkëmoshatarëve – çfarë mund të bëjnë nxënësit pa përfshirë të rriturit në përballimin e dhunës?
- raportimi i dhunës – kur dhe pse është marrë vendimi për përfshirjen e të tjerëve, me këshilla dhe procedura, domethënë, kur bëhet e nevojshme që nxënësit të kërkojnë ndihmë nga të tjerët?

Gjithashtu, çfarë mund të bëhet menjëherë, dhe çfarë duhet dhe mund të bëhet më vonë dhe pse?

Në diskutim theksohet se prioriteti i mbështetjes është siguria personale dhe siguria e viktimës, por gjithashtu se kur situata është shumë kritike, atëherë ka më shumë mundësi për të kërkuar ndihmë.

Mësimdhënësi thekson me nxënësit për nevojën për vetë-kujdes dhe sigurinë e tyre kur bën zgjedhje, si dhe duke praktikuar mbështetje në

situatat më të thjeshta, nxënësit mund të mësojnë të vlerësojnë mirë kur duhet vetë ata të ndihmojnë dhe kur të kërkojnë ndihmë nga të tjerët, të rritur ose bashkëmoshatarët.

Ushtrimi 2: Mbështetje efektive midis bashkëmoshatarëve dhe raportim për dhunën

Në lidhje me skenarët e dhënë, nxënësit duhet të shkruajnë për DHBGJ, tani me fokus mbi:

- drejtimin (formulimi) ndaj viktimës së dhunës, dhe
- formulimin e raportimit të dhunës

Në të dyja rastet duhet përdorur teknikën "flas unë"

Të dëgjuarit aktiv si lloj mbështetjeje

Një nga sfidat kryesore të mbështetjes është dëgjimi me vëmendje. Të dëgjuarit aktiv siguron që ta ndjekim bashkëbiseduesin me vëmendje të plotë dhe të vërtetë, duke mos lejuar që fokusi të kthehet në mesazhet dhe zgjidhjet menjëherë kur ne duam të ndihmojmë. Të dëgjuarit aktiv përfshin shkathtësi reflektuese (parafrazuese) të asaj që kemi dëgjuar, duke e lejuar folësin të konfirmojë, korrigjojë ose sqarojë që të kuptojmë me saktësi. Teknika e reflektimit ndihmon folësin të artikulojë ndjenjat dhe mendimet e tij dhe të sqarojë përvojat e tij. Të dëgjuarit aktiv përfshin edhe gjuhën e trupit dhe nivelin e përfshirjes emocionale, dhe gjithashtu pasqyron atë pjesë të komunikimit. Të dëgjuarit aktiv nuk nënkupton me patjetër pajtim me pikëpamjet dhe mendimet e bashkëbiseduesit, por vetëm konfirmon se kemi kuptuar se çfarë ai/ ajo flet dhe se si ndihet.

Ushtrimi 3: Të dëgjuarit aktiv si mjet për mbështetje

Nxënësit (në çifte) luajnë role të personit A – që ankohet, dhe personi B – që dëgjon në mënyrë aktive, që ta praktikojnë teknikën për të dëgjuarit aktiv. Pastaj, i zëvendësojnë rolet dhe bisedojnë për përvojën që të jesh në rolin e parë dhe të dytë.

E njëjta teknikë përdoret kur dikush është i shqetësuar fort dhe kërkon mbështetje, me pritshmëri të mëdha se dikush do ta dëgjojë dhe kuptojë..

Rezime mbi mbështetjen midis bashkëmoshatarëve – si, kur dhe ku

- Të vepohet në parandalimin e dhunës kërkon guxim dhe njohuri dhe zgjedhja është gjithmonë përgjegjësi e atij që dëshiron dhe mund të ndihmojë.

- Vlerësimi nëse, kur dhe si të ndihmohet, është detyrë e ndihmuesit i cili në çdo kohë duhet ta ketë parasysh sigurinë e tij dhe sigurinë e viktimës, por gjithashtu të dinë se kur duhet të ndihmojnë dhe kur të kërkojnë ndihmë nga të tjerët.

- Të dëgjuarit aktiv është një aftësi për të treguar ndjeshmëri dhe mbështetje, dhe është e suksesshme vetëm nëse tregojmë se çfarë dhe sa e kuptojmë nga ajo që thotë dhe ndjen bashkëbiseduesi.



Çfarë duhet të dijë nxënësi për rolin dhe pasojat për dëshmitarët e DHBGJ-së

Përveç viktimës, edhe dëshmitarët e dhunës pësojnë lëndime dhe ata mund të zhvillojnë ndjenja të forta frike dhe shqetësimi për sigurinë e tyre dhe të tjerëve.

Nxënësit duhet të bëhen të vetëdijshëm për rolin e tyre si dëshmitarë, se qëndrimi dhe sjellja e tyre mbajnë përgjegjësi për parandalimin ose nxitjen e dhunës.

Dëshmitari i dhunës duhet të mësojë të vlerësojë situatën nga një aspekt i fuqisë relative të abuzuesit dhe nga aspekti i sigurisë së vetë dhe të viktimës, dhe më pas të zgjedhë mënyrën më të mirë të veprimit.

Reagimi pozitiv i dëshmitarit mund të jetë i menjëhershëm, por gjithashtu i shtyrë, në varësi të situatës. Në të dyja rastet, mund të jetë e dobishme.



Çfarë duhet të dinë nxënësit për mbështetjen kur duan të ndihmojnë

Nxënësit që duan të ndihmojnë duhet të mësojnë se kur vetë ata duhet ta japin mbështetjen, dhe kur duhet të kërkojnë mbrojtjen nga të tjerët – të rriturit ose bashkëmoshatarët, ose të grupit të trajnuar.

Sigurimi i mbështetjes kërkon aftësi komunikimi, si të dëgjuarit aktiv, dëgjimi me ndjeshmëri, kujdes etj., ku folësi ndjek me vëmendje të plotë dhe autentike, duke mos lejuar që fokusi të kthehet në mesazhet dhe zgjidhjet e sugjeruara nga përkrahësi.



Rekomandime për arsimtarin

Skenarët mbi të cilat punon mësuesi duhet të jenë relevantë dhe të afërt me të rinjtë, me tema të jetës së tyre, në shkollë dhe jashtë saj. Ata duhet të përmbajnë shembuj që janë të njohur dhe lehtësisht të dallueshëm, por jo ekstremë. Është mirë që t'i keni skenarët para fillimit të mësimit.

Mësuesi duhet t'u përmbahet ideve dhe parimeve të përgjithshme të ndihmës, në vend që të tregojë shembuj personalë dhe/ ose ta ndryshojë temën me tregime interesante. Mësuesi duhet të shmangë personalizimin e procedurave dhe rekomandimeve.

Ushtrimet për të dëgjuarit aktiv mund të shoqërohen me ushtrime për të dëgjuarit me ndjeshmëri ose njohjen e emocioneve të fshehura.

TEMA 3:

**Kërkim i ndihmës dhe aftësi
për marrje mbështetje (nga
bashkëmoshatarëve)**

Kur dhe nëse duhet kërkuar ndihmë?

Nxënësit kalojnë nëpër shumë sfida në zhvillimin e tyre, veçanërisht në periudhën e adoleshencës. Është e rëndësishme që ata të jenë të informuar mirë në lidhje me të drejtat e tyre, veçanërisht të drejtave të barabarta, mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes, por edhe për ndihmën nëse disa prej të drejtave shkelen në bazë të përkatësisë ose diversiteti.

Çdokush mund ta gjejë veten në situatë krizash dhe dhimbjeje kur ka nevojë për ndihmë. Kur një nxënës që ka pësuar një lëndim në shkollë do të jetë në një situatë të tillë, pyetjet e para janë: kush, ku dhe nëse duhet të kërkoj ndihmë?

Nxënësve u duhet theksuar se kërkimi i ndihmës është shenjë guximi, jo dobësi, dhe se shpërdorimi i pushtetit mbi dikë justifikon thirrjen për ndihmën për të parandaluar abuzimin. Mbështetja nga një grup më i madh ose i rritur ndonjëherë është enevojshme për të parandaluar shkeljet e të drejtave.

Për të kërkuar ndihmë, si çdo gjë tjetër kërkon aftësi dhe përvojë, por hap hapësirë për ndërhyrje të hershme dhe ndalimin e gjërave që të mos përkeqësohet, dhe që të mos përsëritet sjellja e dhunshme dhe shkatërruese në të ardhmen.

Ushtrim 1 : Vlerësim i situatës nga pikëpamja të rrezikut

Në grupe nga 6 persona, nxënësit analizojnë skenarin e njëjtë, duke e vlerësuar situatën nga aspekti i viktimës dhe nevojës për të ndihmuar – sa serioze është situata, a është viktimë në gjendje t'ia dalë vetë, a duhet kërkuar ndihmë, prej kujt të kërkohet ndihmë (të rriturit, bashkëmoshatarët, prindërit). Grupet referojnë dhe i japin mendimet e tyre.

Përdoren skenarët e njëjtë, vetëm tani nga aspekti i viktimës.

Ku të kërkohet ndihmë?

Për burimet e mundshme të ndihmës nga individët dhe/ose grupet, nxënësit duhet të dinë paraprakisht se ata janë persona të besueshëm që ofrojnë mbështetje në çdo kohë.

Ushtrimi 2 : Persona të besueshëm dhe persona për ndihmë

Mësuesi kërkon prej nxënësve të vizatojnë dy pëllëmbë, dhe në çdo gisht nga pëllëmba e djathtë të shkruajnë emrat e personave të cilët kanë besim, kurse në çdo gisht nga pëllëmba e majtë, emrat e personave të cilët do të donit t'i ndihmonit. Është mirë nëse përmenden anëtarë të familjes, të shkollës, miqtë, fqinjët etj.

Mbështetje midis bashkëmoshatarëve - Mbështetja midis bashkëmoshatarëve është një mundësi të shkëlqyeshme për ndërtim të vazhdueshëm të bashkësive të forta dhe të pavarura.

Tabela 14: Pesë hapa në ofrimin e mbështetjes midis bashkëmoshatarëve

HAPI 1 – Shiko dhe dëgjo me vëmendje të plotë kur nxënësi flet

HAPI 2 – Mendo nëse edhe ti ke qenë në situatën e ngjashme (nëse PO, mos e trego rastin tuaj menjëherë)

HAPI 3 – Imagjino se si do të ndiheshe ti në vendin e biseduesit

HAPI 4 – Zbulo se si ndihet biseduesi nëpërmjet pyetjeve

HAPI 5 – Trego ose bëj diçka që të demonstroshe se je me atë dhe kujdesesh për të

Tejkalimi i rezistencës për të kërkuar ndihmë

Pengesat në rrugën drejt ndihmës janë kryesisht psikologjike - turp, frikë, siklet, mosbesim, por mund të jenë gjithashtu teknike ose organizative: shkolla të mëdha, rrugë/ korridore të paaksesueshëm; të paorganizuar, të

papastër, të mbushur me mobilie, puna në tri ndërrime. Duhet vendosmëri dhe guxim për të kërkuar ndihmë, por duhet edhe ndjenjë të zhvilluar për drejtësi dhe ndjeshmëri ndaj problemeve të dhunës.

Nxënësit duhet të kujtojnë parimet e vetëvlerësimit dhe teknikës "unë flas" si një mjet efektiv në kërkim të ndihmës. Ndhima mund të kërkohet personalisht, ose përmes një grupi shokësh/ Bashkëmoshatarësh të cilët kërkojnë ndihmë për shokun e tyre të klasës.

Përgatitja e nxënësit për të kërkuar ndihmë është momenti kyç në tejkalimin e rezistencës dhe mbështetet në përgjigjen ndaj pesë pyetjeve, të cilat ushtrohen duke luajtur role dhe duke simuluar incidentin.

Tabela 15: Pesë pyetje kryesore për kërkim të ndihmës

KUSH – Kush merr pjesë në kërkimin e ndihmës (p.sh. dy nxënës, arsimtar).

KU – Në cilën hapësirë po ndodh biseda për ndihmë? (hapësira duhet të jetë e përshtatshme, të sigurojë qetësi, privatësi, pa persona të panjohura etj.).

KUR – Cila është koha më e përshtatshme për bisedë rreth çështjeve delikate dhe problemeve urgjente? (pas orëve, gjatë pushimit, menjëherë?)

ÇFARË – Përmbajtja që duhet treguar duhet përpiluar mirë. Akti i dhunës duhet të jetë në fokus. Nuk duhet shkuar nga temë në një temë tjetër.

SI – Është me rëndësi dhe si do të prezantohet problemi – shkurtimisht, qartësisht, me disa poenta dhe pritje të qarta për ndihmën.

Ushtrimi 3: Shkrimi i skenarëve për kërkim të ndihmës

Nxënësit, në çifte, shkruajnë skenarë duke i ndjekur 5 hapat për strategji për të kërkuar ndihmë, pavarësisht nëse ndihmën e kërkon një person i lënduar ose shokët (e klasës) që kërkojnë ndihmë në emrin e tij. Pastaj, i lexojnë skenarët dhe i ndajnë me klasën.

Është, gjithashtu, e rëndësishme që të bisedohet për ndjenjat që gjenden në sfondin e kërkimit të ndihmës, të tilla si frika, shqetësimi, shpresa, etj., dhe çfarë nevojitet si energji dhe fuqi, që kërkimi i ndihmës të zbatohet në praktikë. Gjatë stërvitjes, nxënësit mund të marrin ide për këshilla dhe inkurajimin e nxënësve që kërkojnë ndihmë.

Porosi për mbështetje

Mbështetja do të thotë shumë kur dikush është në situatë problematike. Fuqia e mbështetjes së bashkëmoshatarëve, të paktën vetëm me disa fjalë të thjeshta, mund të jetë shumë e mirëpritur kur të rinjtë vuajnë nga marrëdhënie të padrejta dhe të këqija.

Ushtrimi 4 : identifikimi i dhunës në marrëdhënie partnere

Mësimdhënësi e fillon temën për një nxënëse nga klasa, e cila duket e tërhequr, e shqetësuar dhe e hutuar, për shkak se i dashuri nuk lejon të shoqërojë me shoqen e saj më të ngushtë. I dashuri bën kërcënime se do ta braktisë, duke i treguar se e do dhe e bën këtë për të mirën e saj. Njëherë madje e goditi sepse ka qenë i mërzitur. Ka dy javë që ajo nuk del dhe me askënd nuk shoqëron. Ka frikë se i dashuri do ta braktisë. Nxënësit duhet të shkruajnë një tekst plot fjalësh për mbështetje dhe idesh për strategjitë e mundshme për ta përballuar situatën, si dhe këshilla se ku të kërkon ndihmë.

Në qoftë se bëhet fjalë për mesazhe SMS ose në Instagram me përmbajtje shqetësuese, veprimi është i njëjtë, por edhe me kërkesën që mesazhet e njëjta të dërgohen deri në më të afërmi/e të nxënësës së lënduar.

Pas porosive fillestare për mbështetje, duhet të merrni viktimën edhe në telefon që të bisedoni për ngjarjen dhe ta ndjekin situatën.

Rezyme mbi kërkimin e ndihmës dhe mbështetjen midis bashkëmoshatarëve

Ka situata dhe periudha në jetë kur ndihma dhe mbështetja janë të nevojshme dhe kur është e rëndësishme të kërkohet ndihmë nga të tjerët.

Kur të rinjtë zgjedhin të durojnë padrejtësi dhe dhunë, kjo vetëm çon në përkeqësim, kurrë drejt ndalimi të abuzimeve.

Është e rëndësishme të dihet KU dhe KUSH mund të ofrojë ndihmë për veten ose për të tjerët.

Është gjithashtu e rëndësishme të diskutohet për ndjenjat që qëndrojnë pas nevojës për ndihmë, si frika, shqetësimi, shpresa ...

Kërkimi i ndihmës mund të jetë i vështirë dhe kërkon guxim për shkak të frikës nga dënimi, refuzimi, tallja ose akuza dhe mosbesimi.

Mbështetja është më e fuqishme kur jepet në vendin e duhur dhe në kohën e duhur.



Çfarë duhet të dinë nxënësit për të kërkuar ndihmë?

Të rinjtë duhet të dinë se është mirë të kërkohet ndihmë për veten ose të tjerët dhe se çdo vonesë për të kërkuar ndihmë mund të përkeqësojë situatën dhe të rrisë efektet e lëndimit,

Është mirë që të rinjtë të dinë se mund t'u drejtohen bashkëmoshatarëve të tyre, ata mund të kërkojnë ndihmë nëse vet ata nuk mundën.

Është e rëndësishme për të rinjtë të njohin KU dhe nga KUSH mund të kërkojnë ndihmë për veten ose për të tjerët dhe nëse ata dinë për vendet dhe llojet e ndihmës, ata shpesh mund ta trajtojnë mirë situatën.

Njerëzit mund të jenë në të dyja rolet, dikush që jep ose dikush që kërkon ndihmë.

Vetëbesimi është reagimi më i mirë ndaj dhunës, në krahasim me pranimin e rolit të viktimës. Kjo është mënyra e drejtë për të marrë ndihmë.

Rekomandime për arsimtarin

Është e rëndësishme të jesh një person i mbështetjes për miqtë dhe ata e ndjejnë atë në mënyrë që ata të besohen pa pasur frikë nga pasojat negative. Mbështetja mund të jetë e fortë me disa fjalë / gjeste nëse përfshin njohjen e emocioneve dhe lënë një "derë të hapur" sa herë që është e nevojshme.

SHTOCË

Materiale punë për mësimdhënësit

3.1. Gjetjet nga diskutimi me nxënësit pas rezultateve të hulumtimeve²⁰

Dallimet ndërgjinore në shëndetin mendor, emocional dhe shoqëror të vajzat dhe djemtë 15 vjeçar në R.Maqedoni/ gjetjet nga studimi HBSC, 2014.

Shembull 1: Marrëdhënie të hershme seksuale të të rinjve 15 vjeçarë në Maqedoni

Pyetjes a **keni patur marrëdhënie seksuale**

36% nga djemtë dhe 3% nga vajzat në moshën 15 vjet në Maqedoni, ka përgjigjur pozitivisht.

Ky rezultat, me dallimin e njëjtë midis sekseve, po përsëritet tashmë 12 vjet, në të njëjtin studimin, i cili po zbatohet në çdo katër vjet me nxënës të ndryshëm.

Shembull 2: Mbrojtja nga shtatëzënia e padëshiruar dhe SST të rinjtë 15 vjeçarë me përvojë seksuale në Maqedoni

Pyetjes **gjatë marrëdhënies së fundit seksual, a keni përdorur kondom ju ose partneri/ja?** djemtë dhe vajzat 15 –vjeçare janë përgjigjur kështu:

Mes vajzave 20% nga komuniteti shqiptar, dhe 53% nga komuniteti maqedonas kanë pohuar, ndërsa të djemtë, 62% nga komuniteti shqiptar dhe 63 % djemtë maqedonasë, poashtu, kanë pohuar. Pyeja e njëjtë, e parashtruar në lidhje me përdorimin e kondomit gjatë **marrëdhënies së parë seksuale**, fëmijët e njëjtnë janë përgjigjur si më poshtë.

Mes vajzave 15 vjeçare, vetëm 5% nga shqiptaret dhe 31% nga maqedonet, në Maqedoni, domethënë 48% nga djemtë shqiptarë dhe 51% nga djemtë maqedonasë kanë pohuar se kanë përdorur kondom gjatë marrëdhënies së parë seksual.Në lidhje me përdorimin e pilulare për kontracetim, situata po ndryshohet – 40% nga vajzat shqiptare, përballë 6% të vajzave maqedonase.

Pyetje për diskutim:

1. Çfarë tregojnë këto dallime midis gjinive
2. Çfarë mendoni se është arsyeja për këto dallime?

20 1 Inchley J., Curry D. at al. edit. Growing up Unequal: Gender and Socioeconomic Differences in Young People's Health and Wellbeing – Health Behavior ins School Aged Children (HBSC) Study - International Report from the 2013/2014 Survey; WHO: Health Policy for Children and Adolescent, No 7., 2016

Shembull 3: Krahasime ndërgjinore në sjelljet seksuale te të rinjtë 15 vjeçarë në Evropë

Mesatarja evropiane për përdorimin e kondomave dhe pilulave te të rinjtë 15 vjeçarë, sipas përgjigjeve nga 42 vendet janë:

1. Për kondom M (67%) dhe V (59%)
2. Për pilule M (27%) dhe V (24%)

Çfarë tregojnë këto dallime mes gjinive, në krahasim me dallimet midis djemve dhe vajzave

Shembull 4: Dallimet ndërgjinore në sjelljet shëndetësore te fëmijët në Maqedoni

Shëndeti shoqëror i të rinjve 15 vjeçarë në Maqedoni

Familja:

- Lehtësisht bisedon me babain për gjëra që e shqetësojnë 84%-M; 63%-V
- Lehtësisht bisedon me nënën për gjëra që e shqetësojnë 89%-M; 88%-V

Bashkëmoshatarët:

- Shoqërim i përditshëm me bashkëmoshatarët, para orës 8. 49%-M; 30%-V
- Shokët e klasës janë të sjellshëm dhe ndihmojnë 78%-M; 70%-V

Shëndeti mendor i të rinjve 15 vjeçarë në Maqedoni

- Probleme të shumëfishta shëndetësore, më shpesh se një herë në javë, kanë raportuar: 27%-M; 53%-V
- Aktiviteti intensiv fizik, të paktën 60 minuta për ditë 27%-M; 12%-V

Sjelljet e rrezikshme i të rinjve 15 vjeçarë në Maqedoni:

- Alkool, të paktën një herë në javë: 19%-M; 9%-V
- Të dehur 2-3 herë: 15%-M, 8%-V
- Pervoja seksuale: 36%-M; 3%=V
- Lëndime për të cilët nevojitet kujdes mjekësor, të paktën një herë në vitin e fundit te të rinjtë 15 vjeçarë: 23%-M; 14%-V
- Mbipeshja janë 23%-M; 13%-V, por vetëm 5%-M dhe 10%V, konsiderojnë se janë mbipeshë.

Shëmbull 5: Të rinjtë nën rreziqe (me përvoja të hershme seksuale) me 15 vjet:

Shëndeti shoqëror

- Mbështetje nga prindërit 77%-M; 61%-V;
- Mbështetje nga bashkëmoshatarët 61%-M; 50%-V
- Komunikim elektronik ditor me shokët 58%-M; 44%-V
- Shoqërim pas orëve mësimore 59%-M; 30%-V

Shëndeti mendor

- Ilaçe për qetësimin e nervozizmit 22%-M; 29%-V
- Mendime për vetëvrasje – 8%-M; 30%-V

Sjelljet e rrezikshme:

- Alkool në janë – 24%-M; 22%-V
- Të dehur 2/3 herë – 22%-M; 18%-V
- Pjesëmarrje në grindje 19%-M; 9%-V
- Viktima e shqetësimeve seksuale 18%-M, 5%-V

3.2. Skenar për punën me nxënësit

1. Skenarë për Pjesën 2, kapitulli i tretë, temë 2, punëtori 1 – efektet e dhunës mbi dëshmitarët.

Çfarë medon vajza/ djali në rolin e një viktime, dhe çfarë në rolin e një dëshmitari, dhe si ndihen?

Dy shoqe në rrugën për në shtëpi, janë takuar nga një grup djemsh, të cilët vrapojnë drejt tyre dhe po shtyjnë në një nga vajzat, duke e preku nga të pasmet.



Tre shokë qeshin për fotografi të një shkollë të tyre të klasës i cili është sfaqur me veshje për femra/ krijuar në Photoshop/ publikuar te Facebook



Një djalë më i madh i pengon rrugën një nxënësi dhe nuk i lejon të kalojë nëpër korridor, duke e goditur në kokë dhe duke u tallur për flokët e tij



Në oborrin e shkollës, një nxënëse e re po afrohet një grupi vajzash dhe do t'u shoqërojë, por njëra prej vajzave thotë "Ik, kjo nuk është shoqëri për ty."



2. Skenarë për ndihmë dhe mbështetje ndaj viktimave të dhunës

<p>Gjatë pushimit, njëri prej mjetve në klasë vazhdimisht po ncacmon një vajzë, duke parë se si shokët e klasës po qeshin, ajo është gjithnjë më e padisponuar dhe nuk e di se si të mbrohet.</p>	<p>Javën e kaluar, një grup vajzash filluan të përhapnin thashetheme për shokën e tyre të klasës në Facebook, në lidhje me atë se ku ka shkuar dhe se çfarë ka bërë. Por, ajo ishte shumë e shqetësuar dhe nuk shkoi në shkollë për disa ditë.</p>
<p>Arsimtari nga arsimi fizik rregullisht hyn në dhomat e zhveshjes dhe kontrollon deri ku jemi me të zhveshurit, dhe kur bëjmë stërvitjet, vajzat që janë më të zhvilluara ai i detyron që t'i përsërisin ushtrimet disa herë, ndërsa për pjesën tjetër të nxënësve nuk është aspak e interesuar. Për këtë arsye, shumë vajza nuk vijnë në orët ose janë të çliruar nga detyra që të vijnë në arsim fizik.</p>	<p>Në klasën tonë erdhi një nxënëse e re, një vajzë rome. Një djalë i bëri një aluzion ngjyrës së saj të errët dhe e mbylli hundën, sikur të donte ta mbronte veten nga erëza e keqe. Disa nga shokët e tij qeshin. Dhe në ditët që pasuan, askush nuk kishte miqësi me të.</p>
<p>Në stacionin e autobusit, një djalë iu afrua shoqes sime dhe e kapi për gjokset, dhe vrapoi. Ajo ishte shumë e turpëruar. Të dyjat mbetëm të tronditur.</p>	<p>Shoqja ime më tha se në klasën e tyre një mësues është shumë miqësor me vajzat, ulët në bankën e tyre, i prek nga duart dhe shpatullat, duke komentuar trupin e tyre dhe haptazi jep komplimente për paraqitjen e tyre.</p>
<p>Në hyrjen e shkollës, një djalë imitonte një nxënës të klasës tjetër, duke ecur pas tij, me lëvizje "femërore", ndërsa të tjerët qeshnin me zë të lartë.</p>	<p>Në derën e tualetit të shkollës qëndrojnë një grup djemsh që presin të takojnë disa nga nxënësit më të rinj, të mbyllin derën dhe të mos e lënë atë të dalë nga tualeti. Fëmijët janë të tmerruar dhe nuk e përdorin tualetin.</p>

SHPREHJE TË SJELLSHMËRISË

Bëni një kartoletë	Dërgo një SMS	Jepni një buzëqeshje ose përqafim
Tërhiqeni mbi shpatullën	Ndani me të atë që hani	Ftojeni që të bashkohet me ju
Uluni me të	Flisni për situatën	Luaj një lojë së bashku
Punoni së bashku	detyrat e shtëpisë	Ecni së bashku deri në
shtëpi	Dërgo një fotografi miqësore	Tregoni barcoleta
Ndani me atë prej gjërave tuaja	Ftojeni atë në ditëlindjen tuaj	Këndoni dhe vallëzoni së bashku
Shtërngoni dorën e tij/e saj	Thuani "tung"	Pyet atë se si është, ose se si ndihet
Ndani ndonjë shaka	Jepini ndonjë kompliment	Kërkojini atij / asaj që t'ju ndihmojë
Ofroni ndihmën tuaj	Falni për atë që i ka ndodhur atij/ asaj, nëse ndiheni përgjegjës	Dëgjoni me vëmendje
Postoni një mesazh miqësor në rrjetët shoqërore	Bëni një fotografi së bashku	Ofroni ndihmë në detyrat shkollore
Ngisni biçikletat së bashku	Ftojeni atë që të bashkohet në lojën sportive	Tregoni se jeni kundër sjelljes së dhunshme ndaj atij/ asaj
Shkoni me të që të kërkojë ndihmë ose të raportojë një sulm	Uluni pranë atij/ asaj në autobus	Kërkojini atij / asaj që t'ju ndihmojë për detyrën tuaj
Kërkoni këshilla nga ai/ ajo	Kaloni me atë një pjesë të kohës suaj të lirë pas shkollës	

